

Udhërrëfytyesi për në BE:
**Anëtarësimi përmes
reformës në drejtësinë
penale në Shqipëri**

In partnership with :



Fair

Trials

Rreth Fair Trials

Fair Trials është një vëzhgues global i drejtësisë penale me zyra në Londër, Bruksel dhe Uashington, D.C., që fokusohet në përmirësimin e së drejtës për një gjykim të drejtë në përputhje me standardet ndërkombëtare

Puna e Fair Trials mbështetet mbi besimin se gjykimet e drejta janë një nga gurët e themelit të një shoqërie të drejtë: ato parandalojnë shkatërrimin e jetëve nga dëshimet e drejtësisë dhe i bëjnë shoqëritë më të sigurta duke kontribuar në sisteme transparente dhe të besueshme të drejtësisë që kanë fituar besimin e publikut. Edhe pse në parim njihet botërisht, e drejta themelore e njeriut për një gjykim të drejtë në praktikë po keqpërdoret.

Puna e Fair Trials ndërthur: (a) ndihmën e të dyshuarve për të kuptuar dhe ushtruar të drejtat e tyre; (b) ndërtimin e një rrjeti aktiv dhe të informuar të mbrojtësve të gjyimit të drejtë (ku përfshihen OJQ-të, avokatët dhe akademikët); dhe (c) luftimin e shkaqeve kryesore të gjykimeve të padrejta nëpërmjet kërkimeve, proceseve gjyqësore, advokimit politik dhe fushatave.

Në Evropë, ne koordinojmë Panelin Këshillimor të Ekspertëve Ligjorë - rrjeti kryesor i drejtësisë penale në Evropë, i përbërë nga mbi 200 firma ligjore të mbrojtjes penale, institucione akademike dhe organizata të shoqërisë civile.

Më shumë informacion në lidhje me këtë rrjet dhe punën e tij për të drejtën e një gjykim të drejtë në Evropë mund të gjenden në: www.fairtrials.org

Fair Trials dëshiron të falënderojë Kezia Robson (juriste në Freshfields Bruckhaus Deringer) për kontributin e saj në këtë botim.

Fair Trials, Dhjetor 2020

Kontakt

Bruno Min

Drejtor Ligjor (UK & International), Fair Trials
bruno.min@fairtrials.net

Laure Baudrihay-Gérard

Drejtor Ligjor (Europe), Fair Trials
laure.baudrihay@fairtrials.net



Hyrje fq.5

Përmbledhje ekzekutive p.8

PJESA 1: DIREKTIVA E INTERPRETIMIT DHE PËRKTHIMIT

1. Direktiva 2010/64 / BE mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedimet penale (Direktiva e Interpretimit dhe Përkthimit) **fq.10**
2. E drejta për interpretim / përkthim në ligjin shqiptar **fq.10**
3. Caktimi i përkthyesve dhe interpretuesve **fq.11**
4. Ankimi ndaj refuzimit për të siguruar interpretim / përkthim **fq.11**
5. Kostot e interpretimit / përkthimit **fq.12**
6. Cilësia e interpretimit / përkthimit **fq.13**
7. Rekomandime **fq.14**

PJESA 2: DIREKTIVA E TË DREJTËS PËR INFORMIM

1. Direktiva 2012/13 / BE mbi të drejtën e informimit në procedimet penale (Direktiva e të Drejtës së Informimit) **fq.15**
2. Përkufizimi i termave person "i dyshuar" / "i akuzuar" në legjislacionin penal shqiptar **fq.15**
3. Njohja me të drejtat dhe Letra e të Drejtave **fq.16**
4. E drejta për t'u informuar mbi akuzën dhe provat përkatëse **fq.17**
5. E drejta për tu njohur me dosjen e çështjes **fq.17**
6. Pengesa praktike në aksesimin e materialeve të çështjes **fq.18**
7. Rekomandime **fq.19**

PJESA 3: DIREKTIVAT E SË DREJTËS PËR TU MBROJTUR DHE E NDIHMËS JURIDIKE

1. Direktivat 2013/48 / BE mbi të drejtën e mbrojtjes me avokat në procedimet penale dhe në procedurat e urdhërit evropian të arrestit dhe mbi të drejtën për të pasur një palë të tretë të informuar mbi heqjen e lirisë dhe për të komunikuar me persona të tretë dhe me autoritetet konsullore gjatë heqjes së lirisë (Direktiva e së drejtës së mbrojtjes me akokat) dhe 2016/1919 Për ndihmën juridike për personat e dyshuar apo akuzuar në procedimet penale dhe për personat e kërkuar në procedurat evropiane të urdhër arrestit (Direktiva e Ndhmës juridike) **fp.20**
2. E drejta për t'u mbojtur nga një avokat në ligjin shqiptar **fq.21**
3. Lehtësimi i të drejtës së mbrojtjes me avokat **fq.22**
4. Konfidencialiteti **fq.22**
5. Dhënia e ndihmës efektive ligjore gjatë marrjes në pyetje/investigimit **fq.23**
6. Heqja dorë nga e drejta e mbrojtjes me avokat **fq.23**
7. Përrjashtimet nga e drejta e e mbrojtjes me avokat **fq.24**
8. E drejta për ndihmë juridike **fq.24**
9. Kontributi financiar i personave të dyshuarve / të akuzuar në shpenzimet e ndihmës juridike **fq.24**
10. Apelimi ndaj refuzimit të kërkesës për të përfituar ndihmë juridike **fq.25**
11. Cilësia e ndihmës juridike **fq.25**

12. Kërkesa për të zëvendësuar avokatin e ndihmës juridike **fq.26**
13. Sigurimi i vazhdimësisë së përfaqësimit ligjor **fq.26**
14. Shpërblimi i avokatëve të ndihmës juridike **fq.27**
15. Rekomandime **fq.27**

PJESA 4: DIREKTIVA E PREZUMIMIT TË PAFAJËSISË

1. Direktiva (BE) 2016/343 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim në procedimet penale (Direktiva e Prezumimit të Pafajësisë') **fq.28**
2. Prezumimi i pafajësisë në ligjin shqiptar **fq.28**
3. Media **fq.29**
4. Prezantimi i të dyshuarve **fq.29**
5. E drejta për të heshtur dhe për të mos ndihmuar për fajësimin e vetes **fq.30**
6. Gjykimi në mungesë **fq.30**
7. Rekomandime **fq.31**

PJESA 5: DIREKTIVA E TË MITURVE

1. Direktiva (BE) 2016/800 mbi masat mbrojtëse procedurale për të miturit e dyshuar dhe të akuzuar në procedimet penale (Direktiva për të miturit') **fq.32**
 2. Përmbledhje e sistemit të drejtësisë për të mitur në Shqipëri **fq.32**
 3. Statistika **fq.33**
 4. Ndihma e avokatit **fq.33**
 5. Pyetje dhe regjistrim audio-vizual i pyetjeve të të miturve të dyshuar dhe të akuzuar **fq.34**
 6. E drejta për vlerësim individual **fq.35**
 7. E drejta për një ekzaminim mjekësor **fq.36**
 8. Bartësit e përgjegjësisë prindërore dhe të rriturit e përshtatshëm **fq.36**
 9. E drejta e të miturve për t'u paraqitur personalisht dhe marrë pjesë në gjykimin e tyre **fq.37**
 10. Heqja e lirisë **fq.37**
 11. E drejta për privatësi **fq.38**
 12. Trajtimi në kohë dhe i kujdesshëm i çështjeve **fq.39**
 13. Trainime **fq.40**
 14. Rekomandime **fq.40**
- Përfundime fq.42**

Hyrje

Ky raport bën një krahasim mes ligjeve, politikave dhe praktikave shqiptare me standardet e Ligjet e BE-së në lidhje me të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe personave të akuzuar në çështjet penale. Ai identifikon ndryshimet kryesore midis ligjeve shqiptare dhe atyre të BE-së, që duhet të adresohen përmes ndryshimeve legislative dhe nxjerr në pah pengesat kryesore për zbatimin e tyre në praktikë. Në bazë të gjetjeve, raporti ofron disa rekomandime kryesore praktike për reforma.

Anëtarësimi i Shqipërisë në BE

Që nga viti 2014, Shqipëria është candidate zyrtare për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe në mars 2020, BE hapi zyrtarisht negociatat e pranimit duke njohur përparimin e konsiderueshëm të bërë nga vendi dhe "vendosmërinë e tij për të çuar përpara axhendën e reformave të BE" për t'u bërë Shteti Anëtar më i ri i BE.¹

Gjatë procesit të pranimit, sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe drejtësia janë njohur si sfida thelbësore për Shqipërinë. Kjo pasqyrohet në pesë prioritetet kryesore të identifikuar nga Komisioni Evropian ('Komisioni') për hapjen e negociatave, të cilat të gjitha kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë, të drejtat e njeriut dhe drejtësinë penale,² të cilat vazhdojnë të monitorohen.³ Edhe pse përmirësimet e bëra në këto prioritetet ishin kyçe për hapjen e negociatave, raporti i zgjerimit të Komisionit 2020 bën të qartë që Shqipëria ka ende mjaft vend për përmirësim, sidomos sa i përket të drejtave themelore.⁴

Është shumë e rëndësishme që pajtueshmëria e Shqipërisë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane të sundimit të ligjit dhe të të drejtave të njeriut të jetë subjekt i një vëzhgimi të imtësishëm dhe të plotë gjatë negociatave për anëtarësimin. Kërcënimet ndaj sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut në shtete të ndryshme anëtare të BE-së janë bërë një sfidë serioze në rritje për BE-në vitet e fundit, dhe janë një kujtesë e fuqishme se respektimi i dhe janë një kujtesë e fuqishme se respektimi i vlerave thelbësore të BE-së nuk mund të merret i mirëqenë. BE duhet të sigurojë që vendet candidate mund të besohen që jo vetëm të respektojnë këto vlera, por edhe zbatojnë të drejtat themelore në praktikë, si parakushte të rrepta për t'u pranuar në BE. Përndryshe BE rrezikon të minojë seriozisht vlerat e përbashkëta që mbështesin themelet dhe ruajnë unitetin e saj.

Drejtësia penale dhe anëtarësimi

Megjithëse drejtësia penale është qartazi një prioritet kryesor në procesin e pranimit të Shqipërisë, fokusi kryesor i BE-së ka qenë reforma e gjyqësorit për të përmirësuar transparencën dhe pavarësinë e tij, si dhe trajtimi i korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ndërkohë, pajtueshmëria me standardet minimale për të drejtat e mbrojtjes ka marrë shumë më pak vëmendje.

'Garancitë ligjore për një gjykim të drejtë' janë, sidoqoftë, një pjesë e qartë e 'acquis' të BE-së.⁵ Si të tilla, ato janë pjesë përbërëse e ligjeve dhe rregulloreve të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare që duhet të zbatohen nga vendet candidate në mënyrë që të bashkohen me BE. Përveç standardeve të përcaktuara në Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së, këto rregulla të përbashkëta janë kodifikuar në gjashtë direktiva të cilat janë miratuar në vijim të Udhërrëfyesit të BE-së, 2009 për të forcuar të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe personave të akuzuar në procedimet penale

¹Këshilli i Bashkimit Evropian, Procesi i Zgjerimit dhe i Stabilizim-Asociimit - Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Shqipërisë – Përfundime të Këshillit '7002/20, Bruksel, 25 Mars 2020.

²Komisioni Evropian, 'Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin - Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat kryesore 2013- 2014 'COM (2013) 700, Bruksel, 16 tetor 2013, f.19.

³Komisioni Evropian, 'Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit - Raporti për Shqipërinë 2020 që shoqëron Komunikimin nga Komisioni në Parlamentin Evropian, Këshilli, Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komiteti i Rajoneve - Komunikimi 2020 mbi politikën e zgjerimit të BE', SĚD (1010) 354, Bruksel, 6 tetor 2020.

⁴Ibid

⁵Acquis i BE, Kapitulli 23 'Gjyqësori dhe të drejtat themelore'.

Këto gjashtë **Direktiva të Udhërrëfyesit** janë:

- Direktiva 2010/64 /BE e parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 Tetorit 2010 për të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedimet penale (**Direktiva e interpretimit dhe përkthimit**’);
- Direktiva 2012/13 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 22 majit 2012 për të drejtën e informimit në procedimet penale (**‘Direktiva e të drejtës së informimit**’);
- Directive 2013/48/EU of the European Parliament and of the Council of 22 October 2013 on the right of access to a lawyer in criminal proceedings and in European arrest warrant proceedings, and on the right to have a third party informed upon deprivation of liberty and to communicate with third persons and with consular authorities while deprived of liberty (**‘Access to a Lawyer Directive**’);
- Direktiva 2016/800 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 maj 2016 mbi masat mbrojtëse procedurale për të miturit që janë të dyshuar dhe të akuzuar në procedimet penale (**‘Direktiva për të miturit**’);
- Direktiva 2016/343 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 9 Marsit 2016 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim në procedimet penale (**Direktiva e Prezumimit të Pafajësisë**’); dhe
- Direktiva 2016/1919 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi ndihmën juridike për personat e dyshuar apo akuzuar në procedimet penale dhe për personat e kërkuar në procedimet e urdhërit evropian të arrestit (**‘Direktiva e Ndhmës juridike**’).

Interesi i BE për pajtueshmërinë e Shqipërisë me Direktivat e Udhërrëfyesit

Zbatimi efektiv i Direktivave të Udhërrëfyesit është thelbësor për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, jo vetëm sepse ato janë pjesë e *acquis*, por edhe sepse ato plotësojnë dhe mbështesin përpjekjet për të adresuar prioritetet e BE-së për procesin e pranimit, të theksuara më lart. Një mekanizëm efektiv për trajtimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit duhet të mbështetet nga një sistem i drejtë i drejtësisë penale që garanton të drejtat themelore të të pandehurve. Përmirësimet në transparencën dhe pavarësinë e gjyqësorit do të kenë një ndikim të kufizuar në drejtësinë e rezultateve gjyqësore nëse nuk plotësohen nga një mbrojtje efektive e të drejtave të njeriut në procedimet ligjore.

Transpozimi i Direktivave të Udhërrëfyesit është gjithashtu thelbësor për funksionimin efektiv të mekanizmave të bashkëpunimit të drejtësisë penale të BE-së. Në dy dekadat e fundit, Shtetet Anëtare kanë bashkëpunuar ngushtë në çështjet ndërkufitare, kryesisht përmes mekanizmave të tilla si Urdhri Evropian i Arrestit (**‘UEA’**). Funksionimi i këtyre mekanizmave mbështetet në besimin e ndërsjellë midis autoriteteve gjyqësore të Shteteve Anëtare që secili do të respektojë të drejtat themelore të personave të përfshirë. Efektiviteti i instrumenteve të tilla minohet kur autoritetet gjyqësore në të vërtetë, nuk kanë besim të plotë në pajtueshmërinë e Shteteve të tjera Anëtare me të drejtat themelore.⁶ Një objektiv kryesor i Direktivave të Udhërrëfyesit është të sigurojë një bazë më të fortë për besimin e ndërsjellë midis sistemeve ligjore të Shteteve Anëtare dhe të forcojë efektivitetin e bashkëpunimit ndërkufitar në çështjet e drejtësisë penale. Si i tillë, zbatimi efektiv i këtyre direktivave do të ndihmojë për t’u siguruar që Shqipëria është një partner i besueshëm për ekstradimet, ndarjen e provave dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore, ndër të tjera.

⁶rh. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, Çështja C-216/18 PPU Ministri për Drejtësi dhe Barazi kundër LM dhe çështja C-405/15 Aranyosi dhe Căldăraru.

Rëndësia e Direktivave të Udhërrëfyesit shtrihet përtej kufijve të BE-së dhe shteteve anëtare. Në tërësi, Direktivat e Udhërrëfyesit kodifikojnë, qartësojnë dhe ndërtojnë mbi standardet ekzistuese të së drejtës për gjykim të drejtë të vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ('GJEDNJ') (si dhe nga mekanizma të tjerë rajonale e ndërkombëtare të të drejtave të njeriut). Shqipëria ratifikoi Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut ('KEDNJ') në 1996 dhe përballet me sfida të shumta në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë në çështjet penale. Kjo dëshmohej nga shkeljet që GJEDNJ-së ka gjetur vitet e fundit në lidhje me aspekte të së drejtës për një gjykim të drejtë duke përfshirë mbrojtjen me avokat, ⁷ prezumimin e pafajësisë,⁸ dhe të drejtën për të qenë i pranishëm në gjykim / për rigjykim pas dënimit në mungesë.⁹ Përputhja më e madhe me Direktivat e Udhërrëfyesit mund të ndihmojë në adresimin e shumë prej këtyre sfidave. Përveç ndihmës për të përshpejtuar pranimin e Shqipërisë në BE, këto Direktiva mund të veprojnë si një kut matës për të evidentuar atë çka duhet bërë për të sjellë ligjet shqiptare në linjë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane të të drejtave të njeriut.

Zbatimi praktik

Vitet e fundit, Shqipëria ka filluar një rishikim të madh të ligjeve të saj për t'i harmonizuar ato me standardet e Direktivave të Udhërrëfyesit. Për shembull, ka pasur ndryshime gjithëpërfshirëse në Kodin e Procedurës Penale,¹⁰ dhe në 2017, u miratua një Kod i ri i Drejtësisë Penale për të miturit (Kodi i të miturve') për të sjellë standardet e vendit në përputhje me ligjet e BE-së të drejtësisë për të mitur. Këto janë arritje të konsiderueshme që tregojnë një progres të mirëpritur në avancimin e të drejtave të mbrojtjes në Shqipëri.

Sidoqofte përvojat e Shteteve Anëtare të BE tregojnë se zbatimi i Direktivave të Udhërrëfyesit nuk është

thjesht çështje e ndryshimit të legjislacionit vendas për ta përputhur me standardet e BE. Thjesht ekzistenca e ligjeve që garantojnë të drejtat e gjykimit të drejtë nuk do të thotë se këto të drejta mund të ushtrohen në praktikë. Zbatimi praktik i ligjit të BE kërkon një qasje më gjithëpërfshirëse, duke u siguruar jo vetëm që formulimi i ligjeve lokale të reflektojë standardet e BE-së, por gjithashtu që ato mbështeten nga një kornizë më e gjerë masash që sigurojnë zbatim real dhe efektiv të tyre.

Metodologjia

Kërkimet për këtë raport u kryen nga Civil Rights Defenders dhe Res Publica, të cilët ndërthurën kërkimin në tryezë (desk research) me konsultimet me ekspertë vendas në Shqipëri, bazuar në një kornizë kërkimore të konceptuar nga Fair Trials.

Kjo kornizë kërkimore synon të mbulojë sa më shumë dispozita të Direktivave të Udhërrëfyesit, por i kushton vëmendje të veçantë aspekteve të direktivave që kanë qenë veçanërisht sfiduese për Shtetet Anëtare në procesin e transpozimit. Fair trials kanë qenë në gjendje të identifikojnë këto sfida përmes një bashkëpunimi të ngushtë me Panelin Këshillimor të Ekspertëve Ligjorë ('LEAP'), një rrjet ekspertësh të drejtësisë penale nga të gjitha 27 Shtetet Anëtare të BE-së, që punon për të avancuar të drejtat e gjykimit të drejtë.

Civil Rights Defenders dhe Res Publica zhvilluan konsultime me avokatë lokalë të mbrojtjes penale dhe aktivistë të shoqërisë civile për të kuptuar më mirë se si zbatohen ligjet në praktikë, dhe për të identifikuar sfidat praktike me të cilat përballen personat e dyshuar dhe të akuzuar për vepra penale. Në Janar 2020, ata gjithashtu zhvilluan një takim në Shqipëri, duke bërë bashkë anëtarët e LEAP-it dhe ekspertët shqiptarë të drejtësisë penale për të shkëmbyer njohuritë dhe përvojat e tyre të zbatimit të Direktivave në Shtete të ndryshme Anëtare. Këto diskutime janë bërë pjesë e këtij raporti.

⁷Laska dhe Lika. kundër Shqipërisë, nr. 12315/04 dhe 17605/04, aktgjykim i 20 Prillit 2010, Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë, nr. 33192/07 dhe 33194/07, aktgjykimi i 25 Qershor 2013

⁸Mulosmani k. Shqipërisë, nr. 29864/03, aktgjykim i 8 tetorit 2013, Haxhia k. Shqipërisë, nr. 29861/03, aktgjykim i 8 tetorit 2013.

⁹Shkalla k. Shqipërisë, nr. 26866/05, aktgjykim i datës 10 maj 2011, Izet Haxhia k. Shqipërisë, nr. 34783/06, aktgjykim i 5 nëntorit 2013, Hysi k. Shqipërisë, nr. 72361/11, aktgjykimi i 22 majit 2018, Malo k. Shqipërisë, nr. 72359/11, aktgjykim i datës 22 maj 2018, Muca k. Shqipërisë, nr. 57456/11, aktgjykim i 22 majit 2018, Topi kundër Shqipërisë, nr. 14816/08, aktgjykim i datës 22 maj 2018, Karemani k. Shqipërisë, nr. 48717/08, aktgjykim i 25 shtatorit 2018.

¹⁰Ligji Nr. 35/2017 i datës 30 Mars 2017.

Përmbledhje ekzekutive

Sundimi i ligjit, të drejtat themelore, dhe drejtësia janë njohur si prioritete kyçe për Shqipërinë në procesin e pranimit në BE, dhe ka të ngjarë të vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në bisedimet e pranimit që nisën në 2020.

Zbatimi efektiv i Direktivave të 'Udhërrëfyesit' është i rëndësishëm jo vetëm sepse ato janë pjesë e acquis (rregullat e BE-së që duhet të përfshihen në ligjet e brendshme që vendet candidate të mund të bëhen pjesë e BE-së), por gjithashtu sepse ato luajnë një rol vendimtar në forcimin e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave themelore më gjerë. Duke pasur parasysh që Direktivat e Udhërrëfyesit janë krijuar për të forcuar funksionimin e duhur të instrumenteve të njohjes reciproke të BE-së, zbatimi efektiv i tyre do të ndihmojë gjithashtu për të garantuar që Shqipëria është një partner serioz dhe i besueshëm në mekanizmat e bashkëpunimit të drejtësisë penale të BE-së.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka ndërmarrë reforma gjithëpërfshirëse për të harmonizuar ligjet e brendshme të procedurave penale me Direktivat e Udhërrëfyesit, dhe duket se, në një shkallë të madhe, këto përpjekje kanë qenë të suksesshme. Këto ndryshime, të paktën në letër, paraqesin të drejta të përparuar të mbrojtjes dhe ato po ndihmojnë Shqipërinë që të veprojnë në përputhje me Standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me të drejtën për një gjykim të drejtë.

Një shqyrtim më i afërt i ligjeve dhe praktikave të brendshme, sidoqoftë, zbulon se ka mjaft vend për përmirësim në secilën direktivë dhe se ndryshime të mëtejshme legjislative janë të nevojshme për të siguruar që ligjet e brendshme të jenë në përputhje të plotë me standardet e BE-së. Sidoqoftë, një sfidë shumë më e madhe është të sigurohet që të drejtat e përfshira në Direktivat e Udhërrëfyesit të mund të ushtrohen në mënyrë efektive nga të gjithë personat e dyshuar dhe akuzuar.

Transpozimi i ligjeve të BE-së duhet të shoqërohet me masa që sigurojnë zbatim efektiv, përfshirë këtu përmes sigurimit të burimeve të duhura.

Interpretimi dhe përkthimi: Kushtetuta shqiptare, së bashku me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale ('KPP), garanton të drejtën për përkthim në procedimet penale. Sidoqoftë, ushtrimi i kësaj të drejte nuk mbështetet nga mekanizma të qartë dhe transparent për: (i) të përcaktuar nëse nevojitet interpretim dhe përkthim; (ii) të caktuar (ose kundërshtur vendimet për refuzim përkthimi) një përkthyes apo interpretues; (iii) të garantuar një nivel të caktuar cilësie në ofrimin e këtij shërbimi. Cilësia e ndihmës gjuhësore dëmtohet më tej nga fakti që ligjet e brendshme nuk bëjnë dallimin midis interpretimit (përkthimit me gojë) dhe përkthimit (me shkrim) dhe nuk reflektojnë aftësitë dhe kualifikimet e ndryshme që nevojiten për secilin rol. Ligjet gjithashtu përbejnë disavantazh të madh për të pandehurit që nuk janë mirë ekonomikisht. Kostot e interpretimit dhe përkthimit mund të duhet të paguhet nga i pandehuri nëse ai shpallet fajtor, dhe kjo mund të dekurajojë individët për t'a kërkuar këtë shërbim, edhe kur ai është i nevojshme për të siguruar drejtësinë e gjyqimit të tyre.

E drejta e informimit: Legjislacioni shqiptar parashikon që personat e dyshuar / akuzuar kanë të drejtë të informohen për të drejtat e tyre (përfshirë pajisjen me Letrën e të Drejtave). Sidoqoftë, duket se është praktikë e zakonshme që policia të marrë në pyetje të dyshuarit në mënyrë joformale dhe pa i informuar ata për të drejtat e tyre si të dyshuar, me justifikime të ndryshme, për shembull, duke i thirrur ata si dëshmitarë. Letra e të Drejtave në praktikë duket se u jepet të dyshuarve dhe personave të akuzuar, por ajo është e shkruar me një gjuhë zyrtare duke riprodhuar dispozita ligjore që shumica e tyre ka të ngjarë ta ketë të vështirë t'i kuptojë. Për më tepër, përmbajtja e Letrës së të Drejtave është e kufizuar, por zyrtarët nuk kanë asnjë detyrim formal që të informojnë të dyshuarit / personat e akuzuar për të drejtat e tjera shtesë që nuk përmenden aty.

Mbrojtja me avokat dhe ndihma juridike:

Kushtetuta shqiptare dhe Kodi i Procedurës Penale ('KPP') parashikojnë që cilido që privohet nga liria do të ketë, midis të drejtave të tjera, të drejtën për të komunikuar menjëherë me një avokat dhe të drejtën për t'u mbrojtur me ndihmën e një avokati mbrojtës gjatë procedimeve penale, si dhe gjatë marrjes në pyetje nga policia. Megjithatë, e drejta për t'u mbrojtur me avokat has në disa pengesa praktike, siç është mungesa e ambjenteve të përshtatshme për konsultime private dhe konfidenciale midis avokatit dhe klientit. Gjithashtu duket qartë se nuk ka sisteme të duhura për të garantuar që heqja dorë nga e drejta për ndihmë juridike bëhet pa mëdyshje dhe me zgjuars. Kjo është veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh praktikën e policisë që dekurajon personat e dyshuar / e akuzuar të kërkojnë këshillim ligjor.

Një kërcënim shumë më i madh për ushtrimin efektiv të së drejtës për ndihmë juridike janë sistemet e papërshtatshme dhe të paqarta të ndihmës juridike. Ekzistojnë dy skema të veçanta për ndihmën ligjore që mbivendosen pjesërisht me njëra tjetrën dhe në varësi të rastit, llojit të personit të dyshuar / akuzuar dhe llojit të ndihmës juridike që kërkohet, të dyshuarit / personat e akuzuar mund të jenë të detyruar të paguajnë vetë shpenzimet e ndihmës juridike nëse shpallen fajtorë. Edhe pse kjo nuk shkel në mënyrë të qartë dispozitat e Direktivës së Ndihmës juridike, pasojat personale financiare të marrjes së ndihmës juridike mund të mos i nxisin individët të ushtrojnë këtë të drejtë të tyre themelore për t'u mbrojtur nga një avokat. Veçanërisht shqetësues është fakti se të dyshuarit më vulnerabël kanë më shumë gjasa që t'u kërkohet të paguajnë shpenzimet e tyre ligjore.

Prezumimi i pafajësisë: Prezumimi i pafajësisë është një e drejtë kushtetuese në Shqipëri, dhe ai njihet gjithashtu në KPP. Sidoqoftë, dispozitat në lidhje me ndalimin e deklarimeve publike të fajësisë nga zyrtarët publikë nuk duket se janë transponuar. Në praktikë, kjo ndalesë shkelet rregullisht nga zyrtarët publikë (përfshirë Kryeministrin). Ndiehet gjithashtu nevoja për të siguruar

pajtueshmëri me parimin që personat e dyshuar / e akuzuar duhet të paraqiten në gjykatë në pranga ose në kafaze hekuri apo xhami vetëm atëherë kur kjo kërkohet si masë sigurie; në realitet këto kufizime lirie përdoren rëndom si diçka e zakonshme pavarësisht këtij parimi.

Masat mbrojtëse procedurale për të miturit:

Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur ('KDPM') hyri në fuqi në janar 2018 dhe bazohet kryesisht në Direktivën e të miturve. Ky kod shkon përtej kërkesave të Direktivës së të miturve në aspekte të caktuara dhe ka përmirësuar shumë situatën e të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri. Sidoqoftë, është e qartë se jo të gjitha dispozitat e kodit zbatohen plotësisht, kryesisht për shkak të mungesës së burimeve dhe ambjenteve të përshtatshme. Për shembull, vazhdon të ketë raste kur të miturit mbahen në të njëjtin burg me të rriturit, dhe megjithëse ka pasur iniciativa për ndërtimin e mjediseve të përshtatshme për të mitur për marrje në pyetje dhe hetime, këto ambiente duket se nuk përdoren shumë. Duket gjithashtu e qartë se ka një mungesë personeli mjekësor dhe profesionistësh të tjerë për të siguruar mbështetje për të miturit në konflikt me ligjin, dhe nuk ka sisteme të kënaqshme për trajnimin e avokatëve mbrojtës në mënyrë që ata të ofrojnë një ndihmë efektive juridike.

Pjesa 1:

Interpretation and translation directive

1 Direktiva 2010/64 / BE mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedimet penale (Direktiva e Interpretimit dhe Përkthimit')

- 1.1 Direktiva 2010/64 / BE mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedimet penale (**Direktiva e Interpretimit dhe Përkthimit'**) u kërkon Shteteve Anëtare të sigurojnë që personat e dyshuar dhe të akuzuar që nuk njohin mjaftueshëm gjuhën në të cilën kryhen procedimi, të ndihmohen nga një përkthyes gjatë procedimeve penale, ku përfshihen seancat gjyqësore dhe takimet me avokatin e tyre, dhe se ata kanë të drejtën e përkthimit të 'dokumenteve thelbësore'. Nën këtë direktivë, interpretimi (përkthimi me gojë) dhe përkthimi (me shkrim) duhet të jenë të një cilësie të mjaftueshme për të siguruar drejtësinë e procedurave, dhe sidomos për të siguruar që të dyshuarit dhe personat e akuzuar e kuptojnë çështjen kundër tyre dhe se mund të ushtrojnë të drejtat e tyre të mbrojtjes. Interpretimi dhe përkthimi duhet të vihen në dispozicion falas, pavarësisht nga rezultati i procedimeve. Këto të drejta janë thelbësore pasi rritja e lëvizshmërisë mes shteteve shoqërohet me rritjen e pranisë së të dyshuarve që nuk flasin gjuhën lokale, dhe të cilët varen realisht nga ndihma gjuhësore që të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tjera, të tilla si ajo për të marrë pjesë në gjykimin e tyre ose për të biseduar me avokatin e tyre.

E drejta për interpretim dhe përkthim në Shqipëri

2 E drejta për interpretim dhe përkthim në Ligjin shqiptar

- 2.1 Edhe pse Direktiva e përkthimit dhe interpretimit bën një dallim të qartë mes 'interpretimit' (përkthimi me gojë) dhe 'përkthimit'¹¹ (me shkrim), ligji shqiptar nuk e bën. Kjo për faktin se gjuha shqipe përdor termin 'përkthyes' për t'iu referuar si 'interpretuesve' ashtu edhe 'përkthyesve'. Termi 'interpreton' në shqip

zakonisht u referohet individëve që lehtësojnë komunikimin me personat që kanë pengesa në të folur ose në të dëgjuar.

2.2 Interpretimi (përkthimi me gojë dhe gjuha e shenjave)

E drejta për interpretim në procedimet penale garantohet nga Kushtetuta e Shqipërisë, e cila parashikon që kushdo që nuk mund të flasë ose kuptojë shqip ka të drejtë të ketë një përkthyes falas.¹² Kjo dispozitë plotësohet me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, të cilat mbrojnë të drejtat e të dyshuarve dhe personave të akuzuar për të përdorur gjuhën e tyre, dhe për të folur dhe për t'iu informuar për provat, përmbajtjen e dokumenteve dhe statusin e procedimeve përmes një përkthyesi.¹³ Ekzistojnë dispozita të veçanta në KPP në lidhje me të drejtën e të dyshuarit për t'iu informuar për akuzat (dhe bazën e akuzave) në një gjuhë që ata e kuptojnë,¹⁴ dhe të drejtën për t'iu pyetur në gjuhën e tyre (ose një gjuhë tjetër që ata preferojnë) nëse nuk flasin shqip.

¹¹Nenet 2 dhe 3, Direktiva e Interpretimit dhe Përkthimit.

¹²Neni 31 (c), Kushtetuta e Shqipërisë. Përveç nëse thuhet ndryshe, të gjitha referencat për përkthimet në anglisht të legjislacionit shqiptar rrjedhin nga por përkthim jozyrtar por autoritativ i kryer nga EURALIUS (Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri) (EURALIUS), një projekt i asistencës teknike i financuar nga BE që kërkon forcimin e Sistemit Shqiptar të Drejtësisë) dhe janë në dispozicion këtu: <https://www.euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation>.

¹³Neni 9 (2), KPP.

¹⁴Neni 34a (1) (a) dhe (b), KPP.

2.3 KPP gjithashtu ka dispozita në lidhje me të drejtat e të dyshuarve dhe personave të akuzuar me pengesa në të folur dhe dëgjim që përputhen gjerësisht me Nenin 2 (3) të Direktivës së Interpretimit dhe Përkthimit. Këto përfshijnë të drejtën e përgjithshme të individëve me pengesa në të folur dhe dëgjim për të përdorur gjuhën e shenjave,¹⁵ dhe për të komunikuar me ndihmën e një interpretuesi ('interpretues').¹⁶ Braille njihet si 'gjuhë 'nën KPP.¹⁷

Përkthimi

2.4 Një përkthyes mund të caktohet për të përkthyer dokumente të shkruara nga shqipja në një gjuhë tjetër.¹⁸ Sidoqoftë, ndryshe nga neni 3 (2) i Direktivës,¹⁹ Ligji shqiptar nuk specifikon se cilat dokumente duhet të përkthehen, as nuk e bën të qartë se kush mund të kërkojë përkthime.²⁰ Në praktikë, është autoriteti procedues ('autoriteti kompetent që kryen procedimin në fjalë') që vendos se cilat dokumente duhet të përkthehen.

2.5 Sipas avokatëve praktikues të profesionit, të cilët u këshilluan për këtë raport, fleta e akuzës / akuzave dhe vendimet në lidhje me privimin nga liria normalisht përkthehen dhe u jepen personave të dyshuar/akuzuar. Përkthimet e vendimeve gjyqësore, nga ana tjetër, ofrohen zakonisht (por jo gjithmonë). Megjithatë personit të dyshuar ose akuzuar zakonisht i sigurohet një listë provash, vetë provat ose ekstraktet e tyre rrallë përkthehen. Kjo ndodh sidomos me prova voluminoze dhe / ose opinionet e ekspertëve. Kuadri ligjor nuk përmban ndonjë referencë për mjetet juridike që mund të përdoren në raste të tilla, por supozohet se i pandehuri mund të kërkojë që aktet përkatëse procedurale të quhen të pavlefshme.²¹

2.6 Kjo mungesë specifike në ligjin shqiptar u jep shumë diskrecion autoriteteve kompetente për të përcaktuar se çfarë përkthimesh duhet të bëhen dhe kjo mund ta bëjë më të vështirë për personat e dyshuar dhe akuzuar të kundërshtojnë refuzimet për të siguruar përkthime.

3 Caktimi i interpretuesve dhe përkthyesve

3.1 Sipas KPP, autoriteti procedues 'është përgjegjës për të vlerësuar nëse personi i dyshuar ose i akuzuar ka nevojë për interpretim ose përkthim.²² Sidoqoftë, në kundërshtim me Nenin 2 (4) të Direktivës, ligji shqiptar nuk përcakton një procedurë ose mekanizëm specifik për vlerësimin e nevojave për interpretim dhe përkthim të të dyshuarve dhe personave të akuzuar. Neni 123 (1) i KPP parashikon që nëse i pandehuri deklaron se di shqip, atij mund t'i hiqet e drejta për të patur përkthyes, me presupozimin se i pandehurit mund të vetë-vlerësojë aftësitë e tij gjuhësore dhe të përcaktojë nëse ka nevojë për përkthyes apo jo.

3.2 Aktualisht nuk ka asnjë mekanizëm transparent të caktimit të përkthyesve / interpretuesve nga policia, zyra e prokurorit dhe gjykatat, duke ngritur shqetësime rreth klientelizmit të mundshëm, mungesës së pavarësisë / paanësisë në procedurën e vlerësimit dhe në lidhje me cilësinë e ndihmës gjuhësore të marrë nga të dyshuarit dhe personat e akuzuar.

4 Ankimi ndaj refuzimit për të siguruar interpretim / përkthim

4.1 Ligji shqiptar nuk specifikon se si të kundërshtohen refuzimet për të siguruar interpretim ose përkthim, por ka disa dispozita në KPP që nënkuptojnë se mosdhënia e interpretimit ose përkthimit mund t'a bëjë procedurën të pavlefshme.

¹⁵Neni 98 (2) dhe Neni 8 (2), KPP.

¹⁶Neni 34a (1) (b), KPP.

¹⁷Raporti shpjegues për Ligjin Nr. 35/2017 Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7905 datë 21.3.1995 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.

¹⁸Neni 123 (2), KPP.

¹⁹Neni 3 (2) i Direktivës së Interpretimit dhe Përkthimit parashikon që: "[e] dokumentet thelbësore do të përfshijnë çdo vendim që privon një person nga liria, çdo akuza ose aktakuza, dhe çdo gjykim."

²⁰Në të kundërt, neni 3 (3) i udhëzimit për interpretim dhe përkthim specifikon që: "[t] autoritetet kompetente, në çdo rast, vendosin nëse ka ndonjë dokumenti tjetër thelbësor. Personat e dyshuar ose të akuzuar ose këshilltari i tyre ligjor mund të paraqesin një kërkesë të arsyetuar për këtë qëllim."

²¹Ndërsa neni 3 (5) i Direktivës së Interpretimit dhe Përkthimit kërkon që Shtetet Anëtare të sigurojnë që të dyshuarit ose personat e akuzuar të kenë të drejtën e kundërshtimit të vendimit që konstaton se nuk ka nevojë për përkthim.

²²Neni 126 i KPP parashikon që "autoriteti procedues do të verifikojë identitetin e përkthyesit / përkthyesit, do ta informojë atë për të respektuar konfidencialitetin dhe më pas do ta caktojë atë"

4.2 Sipas nenit 98 (2) të KPP, një person që nuk flet shqip do të merret në pyetje në gjuhën e tij amtare ose në një gjuhë tjetër që ai preferon, por procesverbalet përkatës duhet të mbahen në shqip. Sipas paragrafit 3 të të njëjtit nen, nëse një i dyshuar / i pandehur nuk merret në pyetje në gjuhën e tij ose në një gjuhë tjetër që ai e kupton, procesverbalet do të quhen të pavlefshme.

5 Kostot e interpretimit/përkthimit

5.1 Neni 31 (c) i Kushtetutës së Shqipërisë garanton sigurimin e interpretimit dhe përkthimit

'pa pagesë'. Për më tepër, KPP parashikon që shpenzimet e interpretimit dhe përkthimit do të mbulohen nga shteti,²³ dhe se personat e dyshuar / akuzuar kanë të drejtë të ndihmohen falas nga një përkthyes në mënyrë që të kuptojnë akuzat kundër tyre dhe të ndjekin procesin e tyre ligjor.²⁴

5.2 Në të vërtetë, këto shërbime nuk ofrohen vërtet 'falas', por ato parapaguhën nga autoriteti procedues dhe, nëse i pandehuri dënohet, atij mund t'i kërkohej të paguajë kostot e interpretimit / përkthimit, as kur marrin ndihmë juridike. Nëse një person i dyshuar ose i akuzuar përfiton mbrojtje të detyrueshme sipas nenit 49 të KPP-së,²⁵ ai është përgjegjës për të paguar të gjitha shpenzimet procedurale, duke përfshirë kostot e përkthimit / interpretimit, të bëra gjatë mbrojtjes së detyrueshme.²⁶ Ndihma juridike është e detyrueshme, ndër të tjera, për personat e dyshuar dhe të akuzuar me aftësi të kufizuara, dhe për personat e ndaluar gjatë marrjes në pyetje.

5.3 Nëse një person i dyshuar/akuzuar nuk përfiton mbrojtje të detyrueshme, por nuk është në gjendje të paguajë ndihmën juridike privatisht, ai mund të ketë të drejtën e përjashtimit nga pagesa e kostove të

gjykatës përfshirë shpenzimet për interpretues dhe përkthyes. Megjithatë, edhe në të tilla raste, atyre mund t'iu kërkohej të paguajnë kostot e interpretimit dhe përkthimit të bëra gjatë fazave të procedimit ku ndihma juridike ishte e detyrueshme (për shembull, gjatë marrjes në pyetje nga policia si person i arrestuar apo i ndaluar).

5.4 Kjo ka të ngjarë të pengojë personat e dyshuar dhe akuzuar të kërkojnë përkthyes, edhe pse është e drejta e tyre ta bëjnë këtë, dhe se drejtësia e procedimeve penale ka të ngjarë të minohet seriozisht pa një interpretim efektiv. Veçanërisht shqetësues është fakti që pikërisht të pandehurit e pambrojtur dhe ata që përballen me akuza të rënda preken më keq. Kjo gjithashtu bie ndesh drejtpërsëdrejti me nenin 4 të Direktivës së Interpretimit dhe Përkthimit, i cili kërkon që shpenzimet përkatëse të mbulohen nga shteti "*pavarësisht nga rezultati i procedimeve*".

6 Cilësia e interpretimit/përkthimit

6.1 Përkthyesit dhe interpretuesit emërohen nga një autoritet kompetent nga një listë zyrtare, e cila miratohet çdo vit nga Ministria e Drejtësisë.²⁷ Kjo listë duhet të përmbajë të paktën tre përkthyes për secilën gjuhë të caktuar si gjjuhë zyrtare në konventat ndërkombëtare dhe në marrëveshjet në të cilat Republika e Shqipërisë është palë. Aktualisht në këtë listë ka përkthyes dhe interpretues për 27 gjuhë.²⁸

6.2 Ekziston një procedurë konkurimi për përkthyesit / interpretuesit që do përfshihen në listë, për të cilët kriteret minimale të pranueshmërisë për hyrje janë: një diplomë e studimeve universitare për gjuhën përkatëse; një diplomë juridike në atë gjuhë; ose një minimum prej tre vjet përvojë në mësimdhënie ose si përkthyes në atë gjuhë.

²³Neni 8(3), KPP.

²⁴Neni 123(1), KPP.

²⁵Neni 393(1), KPP.

²⁶Më tej, sipas nenit 486 të KPP, zyra e përbarimit gjyqësor ka për detyrë të rikuperojë çdo shpenzim procedural të papaguar, dhe në rastet e paafëtisë së paguesve të personit të dënuar, përmbartuesi gjyqësor raporton këtë tek autoritetet financiare me qëllim që të kryejë një hetim për gjendjen reale financiare e personit të dënuar. Prokurori gjithashtu mund të kërkojë konfiskimin të pasurive të të pandehurit nëse e konsideron se pasuritë mund të shpërndahen.

²⁷Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave Nr. 3165, datë 12.05.2004 *Për Kriteret dhe Procedurat për Përzgjedhjen e Përkthyesve të Huaj dhe Tarifave të Përkthimit Zyrtar që Duhet Paguar nga Palët e Treta*.

²⁸Anglisht, Italisht, Greqisht, Gjermanisht, Frëngjisht, Spanjisht, Turqisht, Polonisht, Rusisht, Rumanisht, Serbokroatisht, Maqedonisht, Bullgarisht, Hollandisht, Arabisht, Portugez, Hungarisht, Kinez, Çek, Norvegjisht, Suedisht, Persisht, Romani, Vllahisht, Sllovene dhe Japoneze; lista 2018 me emrat e përkthyesve / interpretuesve, gjuha që ata mund të përkthejnë / interpretojnë nga dhe, detajet e tyre të kontaktit, si dhe nëse ata kanë një leje sigurie janë në dispozicion në: <http://www.drejtesia.gov.al/lista-e-perkthyesve-zyrtare-2/>. Pritet që një listë e re e përkthyesve / interpretuesve të miratohet deri në Prill 2020

Nuk ka ligje ose ndonjë instrument tjetër rregullues që kërkon që përkthyesit ose interpretuesit të kenë trajnim të specializuar në interpretim / përkthim (në krahasim me përvojën e të studiuarit dhe punuarit në atë gjuhë), dhe as nuk ka ndonjë kërkesë për trajnim të specializuar mbi terminologjinë ligjore. Përveç listës së Ministrisë së Drejtësisë, nuk ka asnjë regjistër tjetër të specializuar për përkthyes / interpretues dhe gjithashtu nuk ka asnjë organ profesional që i akrediton ata.

- 6.3 Me fjalë të tjera, ligjet dhe politikat e brendshme nuk e njohin nevojën që përkthyesit dhe interpretuesit të kenë aftësi, trajnime ose kualifikime të veçanta për të vepruar si interpretues ose përkthyes përveç zotërimit të gjuhës. Edhe pse Ministria e Drejtësisë mban një listë të ‘përkthyesve’ dhe ‘interpretuesve’, duket se nuk ka asnjë garanci se ata kanë aftësitë dhe përvojën e duhur për të siguruar mbështetjen e nevojshme gjuhësore të një standardi mjaftueshmërisht të lartë.
- 6.4 Në raste emergjence (për shembull, kur një përkthyes / interpretues i përfshirë në listë nuk i përmbush detyrimet e tij kontraktuale), kur ka nevojë për përkthim ose interpretim në një gjuhë që nuk përfshihet në listën zyrtare, ose kur numri i kandidatëve për secilën gjuhë është më i ulët se tre, Ministria e Drejtësisë mund të lidhë një kontratë të veçantë shërbimi me një përkthyes / interpretues të njohur ose me një kompani interpretimi / përkthimi.²⁹ Ndryshe nga përkthyesit / interpretuesit që janë në listën zyrtare, nuk ka kërkesa minimale të pranueshmërisë për përkthyesit / interpretuesit e caktuar në këtë mënyrë.
- 6.5 KPP-ja gjithashtu nuk përcakton se çfarë kualifikimesh duhet të ketë një përkthyes për persona me pengesa në të folur ose dëgjim.³⁰ Neni 107 (4) i KPP-së i referohet vetëm caktimit të “një ose më shumë përkthyesve të zgjedhur midis

personave që janë përdorur për të komunikuar me ta,” dhe Neni 124 (1) (c) parashikon që edhe një anëtar i familjes i personave të tillë mund të caktohet si përkthyes. Pra, nuk ka kërkesa ligjore për t'u siguruar që individët me pengesa në të folur ose në të dëgjuar ndihmohen në mënyrë të përshtatshme nga një profesionist i kualifikuar. Lista e përkthyesve dhe interpretuesve e përpiluar nga Ministria e Drejtësisë nuk përmban përkthyes të gjuhës së shenjave ose shkruar në Braille.

- 6.6 Neni 124 i KPP parashikon arsyet për skualifikimin e një përkthyesi dhe një interpretuesi. Sidoqoftë, cilësia e dobët e interpretimit ose përkthimit nuk përmendet për si arsye për ta zëvendësuar atë.
- 6.7 Avokatët praktikues të profesionit që u konsultuan për këtë studim raportuan se ata shpesh nuk janë të kënaqur me cilësinë e interpretimit dhe përkthimit, dhe se në vend të tyre (kur është e mundur) ata mbështeten në aftësitë e tyre gjuhësore për të komunikuar drejtpërdrejt me klientët e tyre. Kënaqësia me cilësinë e interpretimit / përkthimit duket se varet nga kompleksiteti i procedurave. Për shembull, avokatët ishin përgjithësisht të kënaqur që cilësia e interpretimit / përkthimit u mundëson të dyshuarve dhe personave të akuzuar të kuptojnë akuzat ndaj tyre dhe të marrin pjesë në gjykime të shkurtuara (ku i pandehuri as nuk kundërshton veprimet hetimore që janë kryer tashmë, as kërkon hetime plotësuese). Nga ana tjetër, avokatët shprehën shqetësime në lidhje me cilësinë e interpretimit dhe përkthimit gjatë gjykimeve të plota, si dhe në seancat dëgjimore të paraburgimit.

²⁹Neni 8, Udhëzimi i Përbashkët 3165/2004.

³⁰Vini re se neni 2 (3) i Direktivës së Interpretimit dhe Përkthimit kërkon që Shtetet Anëtare të sigurojnë ndihmën e duhur për personat me dëgjim ose fjalë pengesat

7 Rekomandime

- 7.1 Ligjet në Shqipëri duket se janë në përputhje të plotë me Direktivën e Interpretimit dhe Përkthimit. Kushtetuta e Shqipërisë, e plotësuar nga udhëzimet e KPP, garanton të drejtën për ndihmë gjuhësore në procedimet penale, si për të dyshuarit dhe personat e akuzuar që nuk mund të flasin shqip, ashtu edhe për ata me pengesa në të folur dhe dëgjim.
- 7.2 Megjithatë, ekzistojnë sfida të mëdha që duhet të adresohen për të siguruar që standardet në Direktivat janë efektive në fuqi, veçanërisht:
1. Shërbimet e interpretimit dhe përkthimit nuk janë krejtësisht falas, as për ata që marrin ndihmë juridike;
 2. Ekzistojnë procedura dhe mekanizma të papërshtatshëm për të siguruar që interpretimi dhe përkthimi të ofrohet në një standard mjaft të lartë; dhe
 3. Ekziston shumë diskrecion në lidhje me dokumentet që përkthehen për personat e dyshuar dhe të akuzuar.

Ndihma juridike

- 7.3 Ligjet shqiptare duhet të amendohen për ti sjelle në linjë me Nenin 2(4) të Direktivës, dhe kostot e interpretimit / përkthimit duhet të jenë 0 pavarësisht rezultateve të gjyqit.

Caktimi i interpretuesve/përkthyesve

- 7.4 Duhet të ketë rregulla, politika dhe udhëzime të qarta për vlerësimin e nevojave të ndihmës gjuhësore. Nëse i pandehuri është shtetas i huaj, duhet të prezumohet se ka nevojë t'i caktohet një interpretues apo përkthyes pavarësisht nga niveli i njohjes së gjuhësh shqipe dhe nuk duhet të lejohet heqja dorë nga drejta për një përkthyes / interpretues.

- 7.5 Duhet të ekzistojë një sistem më transparent, i paanshëm për caktimin e përkthyesve / interpretuesve, siç është interpretuesi / përkthyesi "në detyrë" ose një sistem me rotacion.

Cilësia e interpretimit dhe përkthimit

- 7.6 Ligjet dhe politikat shqiptare duhet të njohin dallimin midis përkthyesve dhe interpretuesve, dhe kualifikimet dhe aftësitë e ndryshme që kërkohen për secilin rol, me qëllim nxitjen e një interpretimi dhe përkthimi më efektiv dhe të besueshëm gjatë procedimeve penale
- 7.7 Përkthyesit / interpretuesit duhet të marrin trajnime ose kualifikime të specializuara si përkthyes/ interpretues, dhe t'u kërkohet që të marrin pjesë në trajnime mbi terminologjinë ligjore që të mund të futen në regjistrin zyrtar të përkthyesve dhe interpretuesve.
- 7.8 Ligjet duhet të pranojnë shprehimisht që interpretimi / përkthimi duhet të jetë me cilësi të mjaftueshme, dhe se çdo dështim për të përmbushur këtë standard duhet të përbëjë arsye për të kundërshtuar provat, dhe për të kërkuar zëvendësimin e përkthyesit / interpretuesit.
- 7.9 Nevojitet një sistem rregullator më i fuqishëm për përkthyesit / interpretuesit profesionistë. Për këtë qëllim autoritetet shqiptare dhe palët e tjera të interesit duhet të shohin mundësinë e krijimit të një organi vetërregullues për përkthyes dhe interpretues profesionistë.
- 7.10 Duhet të ketë ligje dhe politika më të forta për të siguruar që përkthyesit në gjuhën e shenjave të kenë aftësitë e nevojshme për të ofruar ndihmë efektive për personat e dyshuar dhe të akuzuar me pengesa në të folur ose të dëgjuar.
- 7.11 Lista zyrtare e përkthyesve dhe interpretuesve duhet të përfshijë interpretues të gjuhës së shenjave dhe transkriptues në Braille.
- ### Përkthimi i dokumenteve
- 7.12 Ligjet duhet të ndryshohen për të përcaktuar minimumin e dokumentet që duhet të përkthehen.

Pjesa 2:

Direktiva për të drejtën e informimit

1 Direktiva 2012/13 / BE mbi të drejtën e informimit në procedimet penale (Direktiva për të Drejtën e Informimit)

- 1.1 Direktiva 2012/13 / BE për të drejtën e informimit në procedimet penale ('Direktiva për të Drejtën e Informimit') zbatohet për personat 'e dyshuar dhe të akuzuar' nga pikëpamja që ata 'bëhen të vetëdijshëm' se dyshohen ose akuzohen për kryerjen e një vepre penale. Sipas kësaj direktive, Shteteve Anëtare u kërkohet të sigurohen që të dyshuarit dhe personat e akuzuar të informohen menjëherë për të drejtat e tyre dhe për akuzat e ngritura kundër tyre.³¹ Të dyshuarve dhe personave të akuzuar që janë arrestuar ose ndaluar gjithashtu duhet t'u jepet një Letër e të Drejtave me shkrim, të cilën ata duhet të kenë të drejtë ta mbajnë gjatë gjithë kohës së ndalimit të tyre.³²
- 1.2 Direktiva për të Drejtën e Informimit gjithashtu kërkon që Shtetet Anëtare të sigurojnë që personave të dyshuar / të akuzuar t'u jepet akses në materialet në zotërim të shtetit me qëllim kundërshtimin e një arrestimi ose ndalimi, dhe për të bërë të mundur që i dyshuari / personi i akuzuar dhe avokati i tyre të mbrohen kundër akuzës në mënyrë efektive.³³ Qasja në këto materiale duhet të jepet menjëherë, në mënyrë që të ushtrohen në mënyrë efektive të drejtat e mbrojtjes.

E drejta për informim në Shqipëri

2 Përkufizimi i termave person 'i dyshuar' / 'i akuzuar' në legjislacionin penal shqiptar

- 2.1 Sipas Kodit Penal, KPP dhe jurisprudencës gjyqësore,³⁴ ekzistojnë dy kategori kryesore personash të dyshuar për kryerjen e një vepre penale - 'i dyshuari' (zakonisht i referuar në legjislacionin shqiptar si 'person nën hetim', dhe 'i pandehuri'. KPP-ja gjithashtu përdor termin i dyshuar në vend të termit person nën hetim, duke sugjeruar që këto dy terma janë të këmblyeshëm

'i dyshuari'

- 2.2 Statusi i saktë i një personi para se të njoftohet për akuzat ndaj tij është i paqartë në ligjin shqiptar. Momenti i parë që një person mund të konsiderohet zyrtarisht "i dyshuar" është kur emri i tij shënohet në regjistrin e njoftimit të veprave penale të prokurorit.³⁵ Në këtë pikë, ai referohet si 'personi të cilit i atribuohet vepra penale'. Ky është personi që një kallëzues ose prokuror e ka identifikuar si autorin e mundshëm të një vepre penale. Nëse plotësohen kushtet e parashikuara, prokurori fillon hetimin penal dhe statusi i personit ndryshon në person *nën hetim*.

³¹Nenet 3 dhe 6, Direktiva për të Drejtën e Informimit.

³²Neni 4, Direktiva për të Drejtën e Informimit.

³³Neni 7, Direktiva për të Drejtën e Informimit.

³⁴Vendim Unifikues Penal I Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 3/2002.

³⁵Neni 287, KPP.

2.3 Sipas avokatëve të konsultuar për këtë studim, është praktikë e zakonshme policore të shoqërosh një person në stacionin e policisë, jo si i dyshuar, por si një dëshmitar i mundshëm për të ndihmuar hetimet ose identifikimin,³⁶ edhe pse policia ka arsye të dyshojë se ai mund të ketë kryer një krim. Më pas, atij mund t'i bëhet presion për të dhënë informacion. Në rrethana të tillë, nëse personi bën deklarata vetë-inkriminuese, marrja në pyetje duhet të ndërpritet, dhe ai duhet të informohet për të drejtën për avokat. Deklaratat e bëra para këtij informimi nuk mund të përdoren kundër tij.³⁷

'I pandehuri'

2.4 Kur janë mbledhur prova të mjaftueshme dhe ka një akuzë për t'u njoftuar autorit të dyshuar të veprës, atëherë personi merr cilësinë e "të pandehurit".³⁸ Një person konsiderohet de jure si i pandehur kur atij i komunikohen akuzat. Akuzat duhet të përmbajnë informacion të mjaftueshëm për arsyet pse ai konsiderohet i pandehur. Legjislacioni shqiptar lejon prokurorin t'i njoftojë akuzat të pandehurit në çdo kohë gjatë fazës së hetimit paraprak.

3 Njohja me të drejtat dhe Letra e të Drejtave

3.1 Personave të dyshuar dhe të akuzuar, qofshin ata të ndaluar apo në liri, duhet t'u jepet Letra e të Drejtave me shkrim, të cilën ata e nënshkruajnë për të treguar se e kanë kuptuar përmbajtjen e saj.³⁹ Policia nuk lejohet të marrë në pyetje një person të dyshuar ose të akuzuar para se ai të jetë informuar për të drejtat e tij në Letrën e të Drejtave.⁴⁰ Deklarimet e bëra nga i pandehuri para se të informohet për të drejtat e tij nuk mund të pranohen si prova.⁴¹

3.2 Në rastet e arrestimit *në flagrancë*, policia duhet të informojë personin e arrestuar për të drejtën e tij për të heshtur dhe të drejtën për t'u mbrojtur me avokat.⁴² Personi i arrestuar duhet të pajiset me Letrën e të Drejtave sa më shpejt që të jetë e mundur, para ose pas mbërritjes së tij në dhomat e paraburgimit.⁴³

3.3 Personat e ndaluar / arrestuar kanë të drejtë të mbajnë një kopje të Letrës së të Drejtave.⁴⁴ Avokatët e konsultuar për studimin konfirmuan se, në përputhje me Nenin 4 të Direktivës për të Drejtën e Informimit, Letra e të Drejtave zakonisht u jepet personave të ndaluar / arrestuar.

3.4 Përmbajtja e Letrës së të Drejtave

Letra e të Drejtave është e njëjtë për të gjithë personat e dyshuar dhe të akuzuar, pavarësisht nëse janë të ndaluar ose në gjendje të lirë,⁴⁵ duke injoruar faktin se për të ndaluarit ose personat e arrestuar ka të drejta të zbatueshme shtesë. Në veçanti, aty nuk ka informacion mbi numrin maksimal të orëve personi mund të mbahet në paraburgim para se të dalë para një autoriteti gjyqësor,⁴⁶ dhe nuk ka asnjë informacion në lidhje me të drejtën për të kundërshtuar arrestimin / ndalimin apo rishikimin e tij para një autoriteti gjyqësor.⁴⁷ Policia ose prokurori nuk kanë asnjë detyrim ligjor mbi për të dhënë këtë informacion personave të ndaluar ose të arrestuar, duke mos i lejuar kështu të kenë njohuritë dhe informacionin e nevojshëm për të ushtruar të drejtën e tyre për liri.

³⁶Neni 297(1) KPP.

³⁷Neni 37, KPP.

³⁸Neni 34, KPP.

³⁹Neni 34 / a (2) dhe Neni 34 / b (2), KPP.

⁴⁰Neni 34 / a (2), KPP, Neni 34 / b (2), KPP, në lidhje me nenin 38 (3), KPP.

⁴¹Neni 38 (3), KPP.

⁴²Neni 255 (1), KPP.

⁴³Neni 255 (3), KPP.

⁴⁴Neni 34 / (2), fjalia e dytë, KPP.

⁴⁵Neni 34 / a (2), KPP, Neni 34 / b (2), KPP.

⁴⁶Pika 12 e Letrës së të Drejtave; përfshirja e këtij informacioni nuk është parashikuar në nenin 34 / b (2), KPP.

⁴⁷Fjalia e fundit e pikës 12 të Letrës së të Drejtave; përfshirja e këtij informacioni nuk është parashikuar në nenin 34 / a, KPP.

3.5 Gjuha e Letrës së të Drejtave përmban disa riprodhime fjalë për fjalë të dispozitave ligjore përkatëse, duke e bërë veçanërisht të vështirë për personat që kanë vështirësi në të mësuar dhe / ose një nivel të ulët arsimit për të kuptuar të drejtat e tyre. Kjo bie në kundërshtim me Nenin 4 (4) të Direktivës për të Drejtën e Informimit ku kërkohet që Letra e të Drejtave të jetë në një gjuhë të thjeshtë dhe lehtë. Policisë i kërkohet të lexojë Letrën e të Drejtave, por ajo nuk ka asnjë detyrim t'u shpjegojë atyre me gojë të drejtat e tyre.⁴⁸ Kjo është e papajtueshme me Direktivën e të Drejtës për Informim, e cila kërkon që të drejtat të shpjegohen në një mënyrë që merr parasysh nevojat specifike të personave të dyshuar/të akuzuar.⁴⁹

3.6 Letra e të Drejtave është në dispozicion në 11 gjuhë të huaja.⁵⁰ Në praktikë, nëse Letra e të Drejtave në gjuhën përkatëse nuk është e disponueshme, caktohet një përkthyes që të shpjegojë me gojë përmbajtjen e Letrës së të Drejtave ose të sigurojë përkthim spontan të dokumentit në gjuhën e të dyshuarit / të akuzuarit në një fletë bosh.

4 E drejta për informacion në lidhje me akuzën dhe provat përkatëse

4.1 Ligji shqiptar parashikon që cilitdo që i është privuar liria ka të drejtë të njoftohet për arsyet e arrestimit, si dhe për akuzat ndaj tij para se të merret në pyetje.⁵¹ Përveç veprës penale (ku përfshihet koha dhe vendi ku dyshohet se është kryer vepra), policia dhe / ose prokurori duhet gjithashtu të informojë të pandehurin në lidhje me provat kundër tij dhe burimet e provave - përveç rasteve kur zbulimi i një informacioni të tillë dëmton hetimin.⁵²

4.2 Sipas avokatëve të konsultuar për këtë studim, personat e ndaluar / arrestuar njoftohen vetëm për akuzat kundër tyre edhe pse sipas KPP-së dhe sipas Letrës së të Drejtave, ata duhet të informohen edhe për bazën e akuzave.⁵³

Faza e fundit në të cilën i pandehuri mund të informohet për akuzat kundër tij është kur prokurori përfundon hetimin dhe njofton të pandehurin për vendimin. Njoftimi, ndër të tjera, duhet të përmbajë një përshkrim të veprës penale që i atribuohet të pandehurit dhe cilësimin juridik të veprës.⁵⁴

5 E drejta për të t'u njohur me dosjen e çështjes

5.1 Personat e dyshuar dhe akuzuar kanë të drejtë të njihen me materialet e çështjes,⁵⁵ si dhe me provat dhe arsyet për arrestimin ose ndalimin e tyre,⁵⁶ me qëllim që t'i kundërshtojnë ato. Avokatët gëzojnë të njëjtat të drejta si klientët e tyre për t'u njohur me materialet e çështjes.⁵⁷

5.2 Nuk është e qartë se kur personat e ndaluar / arrestuar kanë të drejtë të njihen me materialet e çështjes. Nuk ka asnjë dispozitë që kërkon njohjen me dosjen para marrjes në pyetje nga policia,⁵⁸ duke e bërë të vështirë për personat e dyshuar dhe të akuzuar të kundërshtojnë arrestimin dhe ndalimin policor.

5.3 Në praktikë, personave të ndaluar ose të arrestuar u lejohet të njihen me dosjen e çështjes së tyre pak para seancave gjyqësore që gjykojnë mbi ligjshmërinë e paraburgimit. Kur dosja e çështjes jepet para seancave gjyqësore, zakonisht avokatëve u lihen vetëm disa minuta kohë për të parë dosjen në gjykatë. Avokatët e konsultuar për këtë studim raportuan se ata zakonisht lejohen të shikojnë dosjen në bankën e prokurorit, brenda dhomës së gjykatës, ndërsa seanca shtyhet shkurtimisht. Kjo e bën të pamundur që mbrojtja të mbledhë prova për të kundërshtuar argumentet për paraburgimin, që do të thotë se personave të dyshuar dhe të akuzuar nuk u jepet mundësia e duhur për njohjen me dosjen e çështjes për të kundërshtuar paraburgimin.

⁴⁸Neni 255 (2), KPP.

⁴⁹Neni 3 (2), Direktiva për të Drejtën e Informimit.

⁵⁰Letrat e të drejtave janë në dispozicion: http://www.pp.gov.al/web/Akte_te_Tjera_1205_1.php#.XOP9UFzaUk.

⁵¹Neni 28 (1) i Kushtetutës së Shqipërisë. Neni 34 / b (2) dhe (3), KPP, neni 255 (1), CPC, neni 256, KPP.

⁵²Neni 39 (1), KPP.

⁵³Neni 34b (1), KPP në lidhje me Nenin 34 / a (1) (a), KPP; Letra e të Drejtave, pika I.

⁵⁴Neni 327 (3), KPP.

⁵⁵Neni 34 / a (1) (ë), KPP.

⁵⁶Neni 34 / b (1) (b), KPP, pika IX e Letrës së të Drejtave.

⁵⁷Neni 50 (1), KPP.

⁵⁸Neni 34/b (1) and (2), KPP.

5.4 Njohja me dosjen e çështjes, dhe sidomos me burimet e provave mund të kufizohet nëse kjo mund të komprometojë hetimin.⁵⁹ Gjithashtu, prokurori ka fuqinë të urdhërojë, me anë të një vendimi të arsyetuar, që dokumente specifike në dosjen e çështjes "të mbahen sekrete" deri në përfundim të hetimit, nëse zbulimi i tyre do të rrezikonte hetimet.⁶⁰ Si rregull i përgjithshëm, avokatët mbrojtës dhe të pandehurit kanë të drejtë të njihen me dosjen e plotë të çështjes pas përfundimit të hetimit paraprak.⁶¹

5.5 Sipas Udhëzimit Nr.3, datë 26 Tetor 2018 të Prokurorisë së Përgjithshme *Për Vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar si "Sekret Shtetëror"*, informacioni në lidhje me mjetet dhe metodat e përdorura nga autoritetet shtetërore për të trajtuar veprimtari kriminale mund të konsiderohet si "sekret shtetëror", që mund të përjashtohet nga shkresat e çështjes penale. Në këto raste, nuk kërkohet që prokurori të nxjerrë një vendim të arsyetuar për të justifikuar refuzimin për të dhënë informacion. Mënyra se si janë mbledhur provat inkriminuese është informacion thelbësor për mbrojtjen, që i lejon personat e dyshuar dhe të akuzuar të kundërshtojnë ligjshmërinë dhe besueshmërinë e provave që përdoren kundër tyre. Përjashtimi si 'sekret shtetëror' është tepër i gjerë dhe është i papajtueshëm me Direktivën për të Drejtën e Informimit, e cila thotë që kufizimet në njohjen me dosjen duhet të interpretohen 'në mënyrë rigoroze'.⁶² Për më shumë, kjo pengon drejtësinë e procedimit penal dhe mund të hap shteg për mos zbulimin e veprimeve të paligjshme hetimore.

5.6 Në ligjin shqiptar, nuk ka asnjë dispozitë ligjore që përcakton një të drejtë ose procedurë specifike për të kundërshtuar rastet e moslejimit të njohjes me dosjen e çështjes, por personat e dyshuar dhe akuzuar mund të përdorin një dispozitë të përgjithshme të KPP për të deklaruar si " të pavlefshme ".⁶³ provat ose aktet procedurale.

6 Pengesa praktike në aksesimin e materialeve të çështjes

6.1 Kopjet e shkresave të dosjes së çështjes vihen në dispozicion kundrejt një tarife prej 200 lekë (afërsisht 1.6 EUR) për akt ose dokument procedural, përcaktuar sipas Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave Nr. 33 datë 29 Dhjetor 2014 Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, *"Për shërbimin përmbartimor gjyqësor 'shtetëror', Prokurorisë dhe Noterisë"* (**'Udhëzim i Përbashkët 2014'**).⁶⁴ Sidoqoftë, në praktikë, nëpunësit e gjykatave shpesh nuk janë në dijeni të udhëzimit, ose refuzojnë t'a zbatojnë atë. Një avokat i konsultuar për këtë studim raportoi se në një rast, zyrtarët e gjykatës refuzuan dhënien e dosjes së çështjes deri sa u pagua një "tarifë" paarsyeshmërisht e lartë prej 250 EUR (për një dokument me 350 faqe).

6.2 Në zyrat e prokurorëve, situata duket më e mirë. Pavarësisht nga titulli, Udhëzimi i Përbashkët 2014 nuk përmban asnjë dispozitë në lidhje me tarifat që duhet të paguhet për të marrë dosjen e çështjes në zyrat e prokurorëve. Si rezultat, zyrat e prokurorëve kanë miratuar rregullat e tyre për këtë qëllim, ku pjesa më e madhe e tyre aplikojnë një tarifë prej 5 deri në 10 lekë (rreth 0,4 - 0,8 EUR) për faqe. Sidoqoftë, sipas avokatëve të pyetur në këtë studim, avokatëve shpesh u mohohet leja për të bërë kopje të dokumenteve të dosjes së çështjes, dhe në vend të kësaj u lejohet ose vetëm që ta studiojnë dosjen në vend, ose fotografojnë shkresat e çështjes me celularët e tyre..

⁵⁹Neni 39 (1), KPP, Neni 256 (1), KPP.

⁶⁰Neni 279 (1), KPP.

⁶¹Nenet 50 (2) dhe 327 (3) të KPP-së.

⁶²Neni 7 (4) dhe Deklamimi 32, Direktiva për të Drejtën e Informimit.

⁶³Neni 129 (3), KPP.

⁶⁴Përkthim jozyrtar.

7 Rekomandime

- 7.1 Ligji shqiptar përputhet me shumicën e dispozitave kryesore të Direktivës për të Drejtën e Informimit. Personat e dyshuar dhe të akuzuar kanë të drejtën për t'u informuar për të drejtat e tyre (përfshirë atë për t'u mbrojtur me avokat, të drejtën për ndihmë juridike falas dhe mënyrat për ta përfituar atë, të drejtën për t'u informuar për akuzën kundër tyre dhe të drejtën për të heshtur). Të gjithë personat e dyshuar dhe akuzuar duhet, me ligj, të pajisen me një Letër të Drejtash. Ngjashëm me dispozitat në Direktivën e të Drejtës së Informimit, KPP njeh të drejtën për t'u njohur me dosjen e çështjes për të kundërshtuar arrestimin ose ndalimin dhe për të patur një proces të drejtë penal.
- 7.2 Sidoqoftë, një inspektim nga afër i ligjeve dhe praktikave, nxjerr në pah defekte të shumta që çenojnë të drejtat e të dyshuarve dhe personave të akuzuar për të kuptuar të drejtat e tyre dhe për të marrë vendime të informuara në lidhje me çështjet e tyre. Në veçanti, përmbajtja e Letrës së të Drejtave dhe mënyra si jepet informacioni për të drejtat që nuk përputhen plotësisht me Direktivën e të Drejtës së Informimit.
- 7.3 Gjithashtu, është e qartë se ka disa sfida praktike në lidhje me të drejtën për tu njohur me dosjen e çështjes. Duket se ligjet nuk sigurojnë akses mjaftueshëm të shpejtë dhe të duhur për t'i dhënë mundësinë personave të dyshuar dhe të

Cilësia në të cilën merren në pyetje të dyshuarit

- 7.4 Duhet të ketë ndalime më të qarta me ligj për policinë për të marrë në pyetje individë që janë de facto të dyshuar pa i informuar ata se cilësohen si të dyshuar. Duhet të ketë mjete efektive ligjore (përfshirë përjashtimin e provave) nëse këto rregulla shkelen.

Letra e të Drejtave

- 7.5 Letrat e të Drejtave duhet të përmbajnë një listë më të plotë të të drejtave të mbrojtjes, për t'u siguruar që personat e dyshuar dhe të akuzuar janë në gjendje të marrin vendime më të informuara në lidhje me ushtrimin e të drejtave të tyre.
- 7.6 Letrat e të Drejtave duhet të përshtatet për kategori të ndryshme të personave të dyshuarve dhe të akuzuar. Në veçanti, duhet të ketë një Letër të veçantë të të Drejtave për personat e ndaluar dhe një për të miturit, që reflekton të drejtat dhe nevojat ndryshme që ata kanë për një komunikim sa më efektiv.
- 7.7 Letrat e të Drejtave duhet të shkruhen, me ndihmën e ekspertëve ligjorë dhe gjuhësorë, në gjuhë të thjeshtë në mënyrë që ato të jenë të kuptueshme për shumicën e personave të dyshuar dhe të akuzuar.
- 7.8 Policisë duhet t'i kërkohet të vlerësojë aftësinë e të dyshuarit / personit të akuzuar për të kuptuar përmbajtjen e saj, në mënyrë që të jepet ndimë shtesë për t'u siguruar që ata të kuptojnë të drejtat e tyre.

Njohja me materialet e çështjes

- 7.9 Ligji duhet të specifikojë që personave të dyshuar dhe të akuzuar duhet t'u jepet mundësia e hershme e njohjes me dosjet e tyre të çështjes në mënyrë që ata të kenë kohë të mjaftueshme për të kundërshtuar në mënyrë efektive arrestimin ose ndalimin e tyre.
- 7.10 Refuzimi ose mosdhënia e aksesit në dosjen e çështjes duhet t'i nënshtrohet një shqyrtimi gjyqësor efektiv, me mjete juridike efektive.

Pjesa 3:

E drejta e mbrojtjes dhe direktivat e ndihmës juridike

Direktiva e së drejtës së mbrojtjes me avokat

1 Direktivat 2013/48 / BE mbi të drejtën për t'u mbrojtur me avokat në procedimet penale, në procedimet e urdhërit evropian të arrestit, mbi të drejtën për të informuar palët e treta gjatë privimit të lirisë, si dhe për të komunikuar me palët e treta dhe me autoritetet konsullore gjatë privimit të lirisë. (Direktiva e së drejtës së mbrojtjes me avokat') dhe 2016 / 1919 Për ndihmën juridike për personat e dyshuar dhe akuzuar në procedimet penale dhe për personat e kërkuar në procedimet e urdhërit evropian të arrestit (Direktiva e Ndhmës juridike')

- 1.1 Neni 3 i Direktivës së të drejtës së mbrojtjes me avokat përcakton se personat e dyshuar / e akuzuar duhet të kenë të drejtën të mbrohen nga një avokat, atëherë kur dhe në mënyrë të tillë që ata të kenë mundësinë të ushtrojnë të drejtat e tyre të mbrojtjes në mënyrë praktike dhe efektive. Direktiva e bën të qartë se të dyshuarit dhe personat e akuzuar kanë të drejtën të kenë një avokat që në fazat më të hershme të procedimit penal dhe ofron shembuj të llojeve të ndihmës që avokati duhet të jetë në gjendje të sigurojë. Dispozitat e Nenit 3 pasqyrohen në Nenin 2 të

të Direktivës së Ndhmës Juridike, sipas së cilës ndihma juridike duhet të jetë e disponueshme në të gjitha fazat në të cilat një person i dyshuar / i akuzuar ka të drejtën të mbrohet nga një avokat sipas Direktivës së të drejtës së mbrojtjes me avokat.

- 1.2 I dyshuari apo personi i akuzuar mund të heqë dorë nga e drejta për t'u mbrojtur me avokat, vetëm nëse kjo bëhet mbi baza të informuara, dhe vullnetarisht. Direktiva e së drejtës për t'u mbrojtur me avokat gjithashtu parashikon që kjo e drejtë nuk është absolute, dhe se ka përjashtime të lejueshme nga kjo e drejtë. Këto përjashtime janë të lejueshme vetëm në fazën parajudiciale dhe i nënshtrohen kushtëzimeve të ndryshme, përfshirë kushtin që përjashtimi të jetë rreptësisht i kufizuar në kohë.⁶⁵
- 1.3 Sipas nenit 3 të Direktivës së Ndhmës Juridike, 'ndihma juridike' përcaktohet në vija të përgjithshme si financim nga shteti i ndihmës juridike, që mundëson ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes me avokat. Sipas nenit 4 të Direktivës së Ndhmës juridike, Shteteve Anëtare u kërkohet të sigurojnë që të dyshuarit dhe personat e akuzuar që nuk janë në gjendje të paguajnë një avokat të kenë të drejtën e ndihmës juridike aty ku e kërkojnë interesat e drejtësisë. Në përputhje me nenin 6 të Direktivës së Ndhmës Juridike, vendimet për dhënien e ndihmës juridike duhet të merren nga një autoritet 'kompetent', pa vonesa të panevojshme, dhe me kujdes. Neni 7 i Direktivës së Ndhmës juridike kërkon që Shtetet Anëtare të marrin masa që sigurojnë që sistemi i ndihmës juridike ofron shërbime të një cilësie të mjaftueshme dhe se ofrohen trajnime për vendimmarrësit e ndihmës juridike dhe avokatët e ndihmës juridike.

⁶⁵Neni 3 (5) dhe (6) i Direktivës për të drejtën e mbrojtjes me avokat.

2 E drejta e mbrojtjes me avokat në ligjin shqiptar

- 2.1 Neni 31 (ç) i Kushtetutës Shqiptare parashikon që të gjithë kanë të drejtë të mbrohen me ndihmën e një avokati mbrojtës gjatë procedimeve penale. Të dyshuarit dhe personat e akuzuar kanë të drejtën të kenë një avokat privat të zgjedhur prej tyre ose për të kërkuar një avokat të caktuar nga shteti, për t'u konsultuar me avokatin e tyre privatisht dhe për të pasur kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për përgatitjen e mbrojtjes së tyre.⁶⁶
- 2.2 Ka disa raste kur ndihma juridike është 'e detyrueshme' dhe shteti është përgjegjës për caktimin e një avokati, nëse i dyshuari ose personi i akuzuar nuk e ka zgjedhur një.⁶⁷ Personat e dyshuar dhe të akuzuar kanë të drejtën e mbrojtjes së detyrueshme, ndër të tjera, nëse janë nën moshën 18 vjeç, nëse kanë pengesa në të folur ose në të dëgjuar, ose kanë aftësi të kufizuara që pengojnë aftësinë e tyre për t'u mbrojtur. Mbrojtja është gjithashtu e detyrueshme kur personi i dyshuar ose i akuzuar akuzohet për një krim të rëndë, dhe për personat e ndaluar ose të arrestuar gjatë marrjes në pyetje. Edhe pse KPP thekson se në raste të tilla mbrojtja nga një avokat është 'e detyrueshme', edhe nga e drejta për ndihmë juridike, mund të hiqet dorë.⁶⁸
- 2.3 Avokatët praktikues të konsultuar për studimin aktual vunë në dukje se policia shpesh çënon të drejtën e mbrojtjes me avokat duke e shoqëruar një të dyshuar në stacionin policor gjoja për të ndihmuar në hetimet e policisë ose për qëllime identifikimi.⁶⁹ It was also reported by practicing lawyers that it is not uncommon practice for the police to discourage suspects and accused persons from seeking legal assistance by informing them that the case is "open and shut". Police officers might also warn suspects and accused persons that they will be complicating

Duke pasur parasysh që në situata të tilla, individit nuk konsiderohet teknikisht i dyshuar, ai nuk është i informuar për të drejtën e tij për të patur një avokat. Kjo praktikë çënon qartë Nenin 3 të Direktivës së të Drejtës së Mbrojtjes me Avokat. Sidoqoftë deklaratat e bëra nga individët para se të njoftohen për të drejtën e mbrojtjes me avokat, nuk mund të përdoren kundër tyre.⁷⁰

- 2.4 Gjithashtu u raportua nga avokatët praktikues se nuk është praktikë e pazakontë që policia të dekurajojë të dyshuarit dhe personat e akuzuar nga kërkimi i ndihmës juridike duke i informuar ata se çështja është e thjeshtw. Policët gjithashtu mund t'i thonë personit të dyshuar apo akuzuar se marrja e avokatit do t'i komplikonte gjërat, dhe se do të ishte më mirë për ta nëse bashkëpunojnë me policinë. Shqetësime të ngjashme janë shprehur nga Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës i Këshilli Evropian ('KPT').⁷¹ Këto praktika çënojnë ushtrimin e të drejtave të përcaktuara në Direktivën e të Drejtës së Mbrojtjes me Avokat.

⁶⁶Neni 34 / a (1) (ç) (d) (dh) dhe (e), KPP.

⁶⁷Neni 49, KPP.

⁶⁸Vendimet e Gjykatës së Lartë Nr. 13/2005 dhe Nr. 42/2007.

⁶⁹Neni 295 (1) dhe (4), KPP, Neni 109 (1) (dh) Ligji 108/2014 Për Policinë e Shtetit.

⁷⁰Neni 37, KPP.

⁷¹Raport për Qeverinë Shqiptare mbi vizitën në Shqipëri të kryer nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar (KPT) nga 20 deri më 30 nëntor 2018, KPT / Inf (2019) 28, i disponueshëm në anglisht në <https://rm.coe.int/168097986b>, paragrafi 22

3 Aplikimi i së drejtës së mbrojtjes me avokat

- 3.1 Zyra e Prokurorit është përgjegjëse për caktimin e avokatëve të ndihmës juridike bazuar në dispozitat e përcaktuara në Rregulloren e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ('KLP') *Për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në procesin penal*. ('**Rregullorja KLP**'),⁷² e cila u miratua në 2019.
- 3.2 Sipas Rregullores së KLP, Dhoma e Avokatisë duhet t'u sigurojë autoriteteve proceduese (të tilla si policia) një listë vjetore të avokatëve të ndihmës juridike. Lista është në rend alfabetik, dhe avokatët caktohen me sistem rotacioni. Nëse lind nevoja për një avokat të ndihmës juridike, autoritetet proceduese kontaktojnë avokatin e rradhës dhe pyesin për disponueshmërinë e tij. Nëse avokati është në dispozicion, ai ka një orë kohë për t'u paraqitur në vendin e kërkuar (p.sh. në stacionin e policisë). Duke qenë se Rregullorja e KLP është miratuar së fundmi, deri më tani nuk ka qenë e mundur të vlerësohet efektiviteti i saj dhe / ose shkalla e pajtueshmërisë.
- 3.3 Avokatët e konsultuar për këtë studim shpjeguan se para miratimit të Rregullores së KLP ishte praktikë e zakonshme që oficerët e policisë t'i jepnin një listë të avokatëve të regjistruar në skemën e ndihmës juridike të Dhomës së Avokatëve personave të dyshuar dhe të akuzuar, dhe t'i kërkonin të zgjedhin nga kjo listë. Sidoqoftë, këto lista nuk përditësoheshin gjithmonë dhe nganjëherë përfshinin avokatë që nuk ushtronin më profesionin.
- 3.4 Pas përfundimit të hetimit nga prokurori dhe paraqitjes së një kërkesë për të dërguar çështjen në gjyq, gjykata duhet të shqyrtojë nëse i pandehuri ka zgjedhur një avokat. Nëse jo, gjykata duhet të sigurojë një avokat të caktuar nga shteti nëse prania

e një avokati mbrojtës është e detyrueshme.⁷³

Në mënyrë të ngjashme, gjykata që shqyrton ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit duhet gjithashtu të sigurojë praninë e një avokati mbrojtës. Nëse ai nuk paraqitet, gjykata zgjedh një avokat të caktuar nga shteti meqë edhe në këtë fazë prania e një avokati mbrojtës është e detyrueshme.⁷⁴

4 Privatësia

- 4.1 Të dyshuarit dhe personat e akuzuar në liri nuk kanë të drejtën e një takim privat me avokatin e tyre para se të merren në pyetje për herë të parë ndërsa një person i arrestuar / ndaluar ka të drejtë të këshillohet me avokatin mbrojtës menjëherë pas arrestimit,⁷⁵ dhe para se të merret në pyetje nga policia.⁷⁶ Këto dispozita parashtrohen në Ligjin 55/2018 Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë, sipas të cilit avokati ka të drejtë të ketë një takim privat me klientin e tij para marrjes në pyetje për herë të parë dhe në çdo fazë të procedimit penal.⁷⁷ Bisedat midis avokatëve të mbrojtjes, asistentëve të tyre dhe klientët nuk mund të përgjohen,⁷⁸ dhe aktet procedurale të bëra në mungesë të një avokati kur prania e tij është e detyrueshme, do të jenë absolutisht të pavlefshme.⁷⁹
- 4.2 Në bazë të përgjigjeve ndaj pyetësorëve dërguar avokatëve praktikues të profesionit, sfida më e rëndësishme me të cilën ata përballen kur takohen dhe këshillohen me klientët e tyre është mungesa e mjediseve të përshtatshme. Me pak përjashtime, komunikimet dhe konsultimet ndërmjet avokatëve dhe klientëve të tyre bëhen në zyrën e një oficeri policie ose prokurori, pasi ata të kenë liruar dhomën, apo edhe në korridore të stacionit të policisë ose zyrës së prokurorit. Avokatët raportuan se klientët e tyre vihen në siklet për të diskutuar hapur çështjen e tyre me ta, nga frika e mbikëqyrjes dhe përgjimit. Mungesa e mjediseve është veçanërisht e theksuar për konsultimet ndërmjet avokatëve dhe klientëve të tyre gjatë seancave të paraburgimit. Në shumicën

⁷²Miratuar në 12 nëntor 2019. Rregullorja hyri në fuqi në 5 Dhjetor 2019.

⁷³Neni 332 (1), KPP.

⁷⁴Neni 259 (1), KPP.

⁷⁵Neni 53, KPP.

⁷⁶Neni 34 / b (1) (a), KPP.

⁷⁷Neni 11 (c), Ligji 55/2018 Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë.

⁷⁸Neni 52 paragrafi 4, KPP.

⁷⁹Neni 128/a(1)(c), Neni 151 (3), KPP

e rasteve, personi i arrestuar mbahet në një kafaz hekuri dhe avokati duhet të komunikojë me klientin e tij brenda rrezes së dëgjimit të të tjerëve. Kjo është në kundërshtim me Nenet 3 (3) (a) dhe 4 të Direktivës së të Drejtës së Mbrojtjes me Avokat. Sidoqoftë, është raportuar se në disa raste, gjykatësit kanë pranuar kërkesën e avokatit mbrojtës për të dalë nga salla e gjyqit në mënyrë që të lejohej avokati mbrojtës të bisedonte me klientin e tij në privatësi.

5 Sigurimi i ndihmës juridike efektive gjatë marrjes në pyetje / hetim

- 5.1 Prania e një avokati gjatë marrjes në pyetje nga policia është 'i detyrueshëm',⁸⁰ dhe autoriteti procedues (si policia) duhet t'i sigurojë menjëherë një avokat të caktuar nga shteti personit të arrestuar /ndaluar, nëse ai nuk ka zgjedhur ende një avokat.⁸¹
- 5.2 Avokatët e mbrojtjes lejohen të marrin një rol aktiv gjatë marrjes në pyetje të policisë,⁸² ndër të tjera, duke këshilluar klientët e tyre se si t'u përgjigjen pyetjeve, duke ndërhyrë gjatë marrjes në pyetje me qëllim që të japin këshilla (dhe duke kërkuar pushime të shkurtra për të biseduar me klientin e tyre), duke siguruar që përgjigjet e klientit të tyre të regjistrohen si duhet, dhe duke kontrolluar saktësinë e të dhënave të marrjes në pyetje. Ligji shqiptar nuk përmban asnjë kufizim për rolin e avokatëve gjatë marrjes në pyetje.
- 5.3 KPP-ja përmban masa mbrojtëse shtesë që synojnë të sigurojnë që një person i dyshuar ose i akuzuar të ketë akses në ndihmë juridike gjatë gjithë hetimit penal. Pyetjet nga prokurori duhet të bëhen në prani të një avokati.⁸³ Në përputhje me nenet 3 (2) (b) dhe 3 (3) të Direktivës së të Drejtës së Mbrojtjes me Avokat, të gjitha veprimet hetimore të urdhëruara nga prokurori duhet të zhvillohet në prani të një avokati,⁸⁴ përfshirë procedurën e njohjes, ballafaqimet dhe rindërtimet e vendit të ngjarjes.⁸⁵ Nëse avokati i të pandehurit nuk paraqitet pa ndonjë arsye të përligjur, atëhere mund të kryhen veprime hetimore në mungesë të avokatit

mbrojtës, i cili do të gjobitet për mosparaqitje. Nuk ka ndonjë referencë specifike për ndonjë detyrim të autoritetit procedues për të siguruar një avokat tjetër të caktuar nga shteti në raste të tilla.⁸⁶

I pandehuri gjithashtu ka të drejtë të kërkojë praninë e avokatit të tij mbrojtës gjatë kontrollit në shtëpi.

- 5.4 Në raste të tilla, autoriteti procedues duhet të shtyjë kërkimin e shtëpisë për një periudhë maksimale prej dy orësh nga momenti kur avokati mbrojtës informohet për kontrollin.⁸⁷

Heqja dorë nga e drejta e mbrojtjes me avokat

- 6 Të dyshuarit dhe personat e akuzuar mund të heqin dorë nga e drejta për ndihmë juridike, edhe nëse plotësojnë kushtet për mbrojtje 'të detyrueshme'.
- 6.1 Gjykata e Lartë, në Vendimet Nr. 13/2005 dhe Nr. 42 / 2007, vendosi se një person i dyshuar / i akuzuar mund të heqë dorë nga e drejta për t'u mbrojtur me avokat edhe nëse KPP parashikon shprehimisht praninë e detyrueshme të një avokati, përveç rasteve kur ata janë të mitur (ose persona me aftësi të kufizuar për të mbrojtur veten për shkak të një paaftësie fizike ose mendore), dhe në këtë rast mos caktimi i një avokati për t'i përfaqësuar ata do të bënte të pavlefshme veprimet procedurale dhe dokumentimin e procedimit penal.
- KPP është ndryshuar për të përfshirë në mbrojtjen e detyrueshme kategori të reja personash të dyshuar dhe akuzuar. Sidoqoftë, KPP-ja e ndryshuar rishtas nuk shpjegon nëse mund të hiqet dorë nga mbrojtja e detyrueshme. Nga ana tjetër, neni 48 (4) dhe (5) i Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur shprehimisht parashikon që sigurimi i një avokati është i detyrueshëm për të miturit në konflikt me ligjin (në përputhje me jurisprudencën ekzistuese të Gjykatës së Lartë) dhe se mos caktimi i një avokati do ta bëjë të papranueshme çdo deklaratë të dhënë nga i mituri.

⁸⁰Neni 256 (1), Neni 296 dhe Neni 167 (3), KPP.

⁸¹Neni 49 (1) (e), KPP.

⁸²Neni 38, KPP, neni 50, KPP.

⁸³Neni 256 (1), KPP.

⁸⁴Neni 304 (2), KPP.

⁸⁵Neni 171 (4), KPP, Neni 304 (1), KPP.

⁸⁶Neni 49 (4) dhe (5), KPP.

⁸⁷Neni 205 (2), KPP.

- 6.3 Nuk ka ligje specifike ose politika zyrtare në lidhje me heqjen dorë nga e drejta e mbrojtjes me avokat (për të dyshuarit dhe akuzuarit e rritur). Në praktikë, forcat policore përfshijnë tre zgjedhje në procesverbalin e arrestimit në flagrancë të një personi, ku shkruhet përkatësisht: (i) "Unë kam zgjedhur një avokat mbrojtës dhe do ta njoftoj menjëherë"; (ii) "Unë nuk kam një avokat të zgjedhur privatisht, por do doja të më caktohej një avokat kryesisht "; dhe (iii) "Unë nuk dua avokat". Personit të dyshuar ose arrestuar i kërkohet të zgjedhë duke shënuar kutinë përbri zgjedhjes së tij (tick box) dhe të nënshkruajë procesverbalin. Heqja dorë nga mbrojtja, thjesht me një veprim të tillë është qartazi i papajtueshëm me nenin 9 të Direktivës së të Drejtës së Mbrojtjes me Avokat, e cila kërkon që të dyshuarve dhe personave të akuzuar t'u sigurohet informacion në lidhje me të drejtat e tyre dhe për pasojat e mundshme të heqjes dorë nga ajo

7

Përfshirje nga e drejta e mbrojtjes me avokat

7.1

Në përgjithësi, KPP nuk përmban asnjë përfshirje nga e drejta e mbrojtjes me avokat. Përfshirja i vetëm duket se është në nenin 296 (2) të KPP-së, sipas të cilit policia mund të marrë informacionin e nevojshëm për vazhdimin e hetimit nga një person i dyshuar ose i akuzuar, qoftë në vendin e krimit ose menjëherë pasi të marrë dijeni për veprën, edhe në mungesë të mbrojtjes. Në raste të tilla, informacioni i marrë nuk do të dokumentohet dhe përdorimi i tij si provë nuk lejohet.

Direktiva e Ndhmës Juridike

8 E drejta për ndihmë juridike

- 8.1 Ndhimja juridike vihet në dispozicion në të gjitha fazat kur një i dyshuar / person i akuzuar ka të drejtën e mbrojtjes me avokat, përfshirë këtu para dhe gjatë marrjes në pyetje nga policia, si dhe menjëherë pas heqjes së lirisë.⁸⁸

9 Kontributi financiar i personave të dyshuar/ akuzuar në shpenzimet e ndihmës juridike

- 9.1 Ndhimja juridike në Shqipëri nuk është plotësisht falas për të gjithë të personat e dyshuar dhe akuzuar që kualifikohen për ndihmë. Në disa raste, atyre mund t'u kërkohet të paguajnë të gjitha ose një pjesë të shpenzimeve të ndihmës juridike nëse dënohen.
- 9.2 Ndhimja juridike mund të sigurohet përmes njëres prej dy skemave të ndihmës juridike – KPP-së, ose sipas Ligjit Nr. 111/2017 *Për Ndhimën Ligjore të Garantuar nga Shteti* ('Ligji për Ndhimën Juridike'). Sipas nenit 49 të KPP-së, personat e dyshuar dhe të akuzuar kanë të drejtë për ndihmë juridike përmes mbrojtjes së detyrueshme ndërsa ata që nuk përfitojnë mbrojtje të detyrueshme, mund të kërkojnë ndihmë juridike, përmes nenit 49 / a të KPP-së, ose sipas Ligjit për Ndhimën Juridike. Nuk është e qartë se kur ndodh caktimi i avokatit sipas Nenit 49 / a të KPP-së, apo sipas Ligjit për Ndhimën Juridike. Në 2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë miratoi një rregullore ('Rregullorja e KLP 2019') për të dhënë udhëzime të mëtejshme në lidhje me ofrimin e ndihmës juridike dhe caktimin e avokatëve të ndihmës juridike.⁸⁹ Kjo rregullore duket se njeh KPP-në dhe Ligjin për Ndhimën Juridike si regjime të veçanta për ndihmë juridike, por nuk jep sqarime të dobishme për marrëdhëniet midis tyre. Për më tepër, rregullorja përmban referenca të gabuara ndaj dispozitave të KPP-së, duke shtuar konfuzionin mbi qëllimin e dy skemave të ndihmës juridike.
- 9.3 Dallimi kryesor midis ndihmës juridike sipas KPP-së dhe Ligjit për Ndhimën Juridike është rikuperimi i kostove të ndihmës juridike prej personave të dyshuar dhe akuzuar. Kosto e ndihmës juridike (dhe kostot e tjera të procedurave ligjore) sipas skemës së ndihmës juridike të KPP-së janë gjithmonë të rikuperueshme nëse një i pandehur shpallet fajtor, pavarësisht mundësive të tij financiare.⁹⁰ Nuk ka përfshirje nga detyrimi për të paguar shpenzimet procedurale, dhe zyra e përbarimit gjyqësor ka për detyrë të rikuperojë çdo shpenzim procedural të

⁸⁸Neni 34 / a (1) (d), KPP Neni 34b (1) dhe (1) (a), KPP.

⁸⁹Rregullorja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) mbi rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike detyrore në procesin penal.

⁹⁰Neni 393 (1), KPP

paguar. Nëse i dënuari është i paaftë të paguajë, përbaruesi njofton autoritetet financiare me qëllim ata të kryejnë një hetim mbi situatën reale financiare të personit të dënuar.⁹¹

- 9.4 Nga ana tjetër, sipas Nenit 26 të Ligjit për Ndhimën Juridike, përfituesit e ndihmës juridike ‘dytësore’ (d.m.th. përfaqësimi ligjor) në procedimet penale kanë të drejtën e përjashtimit nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore, përfshirë shpenzimet për përkthyesit. Sipas kësaj skeme, shpenzimet juridike paguhen nga shteti,⁹¹ dhe personave të dyshuar / të akuzuar nuk do t’u kërkohet të paguajnë paraprakisht për ndihmë juridike.
- 9.5 Është shqetësuese se për shkak se të dyshuarit më vulnerabël dhe individët që përballen me akuza të rënda penale kanë të drejtën e mbrojtjes së detyrueshme, ata mund të marrin vetëm ndihmë juridike sipas KPP-së, që i kërkon atyre që të paguajnë kostot e ndihmës juridike nëse dënohen. Edhe pse ndihma juridike nuk ndalon në mënyrë të qartë rimbursimin e kostove të ndihmës juridike, risku financiar i marrjes së një avokati të ndihmës juridike shërben si pengese për të dyshuarit dhe personat e akuzuar për të kërkuar ndihmë juridike. Rregullat e ndihmës juridike janë gjithashtu qartazi diskriminuese - duke i bërë të dyshuarit më vulnerabël, më të prekshëm ndaj vështirësive financiare në procedimet penale.
- 9.6 Për më tepër, duke pasur parasysh që personat e dyshuar dhe akuzuar kanë të drejtën e mbrojtjes së detyrueshme kur merren në pyetje si persona të ndaluar ose të arrestuar,⁹³ ka shumë mundësi që shumë prej tyre do marrin ndihmë juridike të detyrueshme, në një fazë të caktuar të procedimeve penale. Kjo do të thotë që disa të dyshuar mund të kualifikohen për ndihmë juridike sipas Ligjit të Ndhimës Juridike në pjesën më të madhe të fazave të procesit penal, ndërkohë që ndihma juridike gjatë marrjes në pyetje nga policia mbulohet nga regjimi i ndihmës juridike të KPP-së (kostot e të cilit mund të duhet t’i kthehen shtetit në një moment të dytë). Është e

papranueshme që mund të ketë stimuj financiarë për të refuzuar ndihmën juridike sidomos gjatë gjatë marrjes në pyetje nga policia - një fazë në të cilën personat e dyshuar dhe të akuzuar janë ndoshta më të cënueshëm ndaj abuzimeve të të drejtave të njeriut dhe ku ndihma juridike është veçanërisht e rëndësishme.

10 Kundërshtimi i refuzimit të ndihmës juridike

- 10.1 KPP nuk parashikon në mënyrë të qartë asnjë mjet juridik për të kundërshtuar refuzimin për të caktuar një avokat të ndihmës juridike dhe nuk ka udhëzime të qarta të dhëna në Rregulloren e KLP, 2019.
- 10.2 Sipas Ligjit për Ndhimën Juridike Dytësore, personi të cilit i është refuzuar kërkesa për ndihmë juridike ka të drejtë t’u apelojë atë përpara gjykatës penale të shkallës së parë që shqyrton meritat e çështjes kundër tyre.⁹⁴ Nëse gjykata refuzon, kërkuesi i ndihmës juridike mund ta kundërshtojë atë me anë të një ankimi të veçantë para Gjykatës së Apelit.⁹⁵

11 Cilësia e ndihmës juridike

- 11.1 KPP nuk përmban ndonjë dispozitë në lidhje me cilësinë e ndihmës juridike. Duket se supozohet se një avokat i cili është anëtar i Dhomës së Avokatëve dhe është anëtarësuar në skemën e ndihmës juridike është i kualifikuar për të dhënë një ndihmë juridike efektive.
- 11.2 Ligji për Ndhimën Juridike parashikon se është detyrë e Ministrit të Drejtësisë të miratojë kriteret dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike, si dhe procedurat e mbikëqyrjes së shërbimeve të ndihmës juridike dytësore (d.m.th. përfaqësimi në gjykatë) nga Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas.⁹⁶ Sipas të njëjtit ligj, Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas është përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë së ndihmës juridike të ofruar.⁹⁷

⁹¹Neni 486, KPP

⁹²Neni 485, (KPP)

⁹³Neni 49, KPP.

⁹⁴Neni 21 (4), Ligji për Ndhimën Juridike.

⁹⁵Neni 22 (7), Ligji për Ndhimën Juridike.

⁹⁶Neni 7 (f), Ligji për Ndhimën Juridike.

⁹⁷Neni 8 (1) (l), Ligji për Ndhimën Juridike.

11.3 Sipas Rregullores së KLP 2019,⁹⁸ autoritetet kompetente (Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe Dhoma e Avokatëve) duhet të hartojnë dy lista: njëra që përmban avokatë të praktikës së përgjithshme dhe tjetra që përmban avokatë të specializuar në çështje për të mitur në konflikt me ligjin, viktimë të trafikimit, dhunës në familje dhe abuzimit seksual.⁹⁹ Mbetet të shihet nëse avokatët nga lista e dytë do të caktohen për të përfaqësuar si kallëzuesin ashtu edhe të pandehurin në procedimet penale. Rregullorja gjithashtu parashikon që personit të ndaluar / arrestuar ose të pandehurit i kërkohet nga autoriteti procedues të plotësojë një formular për të vlerësuar cilësinë e shërbimit të ofruar nga avokati i ndihmës juridike.¹⁰⁰

12 Kërkesa për zëvendësimin e avokatin e ndihmës juridike

12.1 As KPP-ja dhe as Ligji për Ndhmën Juridike nuk njihet në mënyrë specifike të drejtën e personave të dyshuar dhe akuzuar për të kërkuar zëvendësimin e avokatit të tyre të ndihmës juridike. Sidoqoftë, sipas Rregullores së KLP 2019, personi i dyshuar/akuzuar të cilit i është dhënë ndihmë juridike sipas Ligjit të Ndhmës Juridike mund të kërkojë zëvendësimin e avokatit vetëm në kushtet e konfliktit të interesi.¹⁰¹

13 Sigurimi i vazhdimësisë së përfaqësimit ligjor

13.1 Sipas Rregullores së fundit të KLP 2019, autoritetet proceduese duhet të sigurojnë respektimin e parimit të vazhdimësisë së përfaqësimit ligjor, për aq sa është e mundur.¹⁰² Në praktikë, sidoqoftë, kjo bëhet e mundur vetëm nëse avokati përfshihet si në listën e hartuar nga Dhoma e Avokatëve ashtu edhe në skemën e ndihmës juridike sipas Ligjit për Ndhmën Juridike.

14 Shpërblimi i avokatëve të ndihmës juridike

14.1 Nëse një avokat i ndihmës juridike caktohet sipas KPP (siç ndodh me shumicën dërrmuese të avokatëve

të ndihmës juridike penale), ata paguhen sipas skemes së tarifave të shpërblimit të avokatëve të ndihmës juridike të miratuar nga Urdhri i përbashkët i Ministrisë të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë Nr. 1284/3, datë 16 Mars 2005 Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike.¹⁰³ Avokatët paguhen në bazë të kategorisë së çështjes penale, fazës dhe natyrës së procedimit, pavarësisht nga natyra e punës së bërë nga avokati i ndihmës juridike.

14.2 Për shembull, tarifa për përfaqësim ligjor në gjykatën penale të shkallës së parë për krime të dënueshme me burgim deri në pesë vjet, sipas Urdhrit të përbashkët është 30,000 lekë (afërsisht 245 EUR), pavarësisht nga numri i seancave dëgjimore ose kompleksiteti i çështjes. Kjo nuk pasqyron vlerën cilësinë dhe volumin e punës së bërë nga avokatët e ndihmës juridike, dhe nuk ka asnjë mundësi që avokatët e ndihmës juridike të kërkojnë pagesë shtesë për arsye të jashtëzakonshme.

Burimi i financimit të ndihmës juridike në procedimet penale

14.3 Nën KPP, zyra e prokurorit dhe gjykatat janë përgjegjëse për pagesën e avokatit të ndihmës juridike nga buxhetet e tyre, në varësi të fazës në të cilën bëhet caktimi i avokatit të ndihmës juridike (përkatesisht hetimit paraprak / procedurave gjyqësore).

14.4 Nëse avokati i ndihmës juridike është caktuar në bazë të Ligjit për Ndhmën Juridike, ai paguhet nga Buxheti i Ndhmës Juridike i cili i propozohet Ministrisë të Financave nga Ministri i Drejtësisë.¹⁰⁴ Buxheti administrohet nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.¹⁰⁵ Për më tepër, Drejtoria është përgjegjëse për miratimin e një kontrate shërbimi model dhe nënshkrimin e kontratave vjetore të shërbimit me avokatët që do të ofrojnë shërbime juridike.¹⁰⁶

⁹⁸Rregullorja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) mbi rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike detyruese në procesin penal.

⁹⁹Nenet 6 dhe 7, Rregullorja e KLP.

¹⁰⁰Neni 33, Rregullorja e KLP.

¹⁰¹Neni 30 (b), Rregullorja e KLP.

¹⁰²Neni 13, Rregullorja e KLP.

¹⁰³Përkthim jozyrtar. 104 Neni 7 (b), Ligji për Ndhmën Juridike.

¹⁰⁵Neni 8 (2) (c), Ligji për Ndhmën Juridike.

¹⁰⁶Neni 8 (2) (i) dhe (k), Ligji për Ndhmën Juridike

Sfidat me të cilat përballen avokatët e ndihmës juridike në marrjen e pagesës për shërbimet e tyre

- 11.5 Sfidat e hasura nga avokatët në sigurimin e pagesës për shërbimet e tyre paraqiten në Raportin Vjetor të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor 2014. Sipas raportit, Urdhri i Përbashkët Nr. 1284/3 i Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, datë 16 Mars 2005, nuk përmban dispozita të hollësishme që rregullojnë llogaritjen e tarifave për avokatët e caktuar nga shteti dhe mënyrat për pagesën e tyre. Vihet re gjithashtu se shumë gjykata shpesh u japin avokatëve të caktuar nga shteti tarifa më të larta se ato të përcaktuara në Urdhrin e Përbashkët.

15 Rekomandime

- 15.1 Ligjet shqiptare duket se përputhen gjerësisht me shumicën e dispozitave të Direktivës së mbrojtjes me Avokat dhe Direktivës së Ndhmës juridike. Personat e dyshuar dhe të akuzuar kanë të drejtën të mbrohen me avokat që në fazat më të hershme të procedimit penal, përfshirë marrjen në pyetje nga policia. Ndhma juridike është e disponueshme në të gjitha fazat kur një i dyshuar ose person i akuzuar ka të drejtën e mbrojtjes me avokat. Sidoqoftë, në praktikë, ka pengesa të konsiderueshme që dëmtojnë ushtrimin efektiv të këtyre të drejtave dhe është shqetësim serioz që të dyshuarit dhe personat e akuzuar më vulnerabël përballen me disavantazhe serioze në lidhje me ndihmën juridike.

Ndhma juridike efektive

- 15.2 Gjykatat, autoritetet e ndjekjes penale dhe policia duhet të sigurohen që ka mjedise të përshtatshme për konsultime private klient-avokat, edhe në stacionet policore.
- 15.3 Duhet të monitorohet zbatimi i reformave që fusin parimin e sistemit me rotacion për caktimin e avokatëve. Duhet të ekzistojë një skemë efektive e avokatëve në detyrë për të siguruar që personave të dyshuar dhe të akuzuar t'u garantohet mundësia për një ndihmë të paanshme ligjore gjatë gjithë procedimit penal, veçanërisht në fazat e hershme.

Heqjet dorë

- 15.4 Duhet të ketë masa mbrojtëse më të mira për të siguruar që heqja dorë nga e drejta për t'u mbrojtur me avokat jepet pa mëdyshje, me vetëdije dhe me inteligjencë.

Ndhma juridike

- 15.5 Personave të dyshuar dhe të akuzuar që nuk janë në gjendje të paguajnë për shërbimet juridike privatisht nuk duhet t'u kërkohej të paguajnë shpenzimet e ndihmës juridike nëse dënohen.
- 15.6 Dy skemat e ndihmës juridike aktualisht në veprim duhet të thjeshtohen në mënyrë që të ketë qartësi dhe siguri më të madhe për personat e dyshuar dhe akuzuar që nuk kanë mjete financiare për të përballuar ndihmë juridike private, dhe për të siguruar që të pandehurit e pambrojtur nuk diskriminohen.

Cilësia e ndihmës juridike

- 15.7 Të gjithë avokatët e ndihmës juridike duhet t'i nënshtrohen një kontrolli më të rreptë të cilësisë.
- 15.8 Sistemi i shpërblimit të avokatëve të ndihmës juridike duhet të rishikohet në mënyrë që ata të kompensohen në mënyrë adekuate dhe të drejtë për punën e tyre.

Pjesa 4:

Direktiva e prezumimit të pafajësisë

1 Direktiva (BE) 2016/343 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim në procedimet penale (Direktiva e Prezumimit të Pafajësisë')

- 1.1 Direktiva (BE) 2016/343 mbi forcimin e aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim në procedimet penale ('Direktiva e Prezumimit të Pafajësisë') riafirmon që personat e akuzuar dhe të dyshuar kanë të drejtë të prezumohen të pafajshëm. Aty thuhet se barra e provës për vërtetimin e fajësisë i mbetet prokurisë dhe se çdo dyshim në lidhje me çështjen e fajit duhet të jete në benefit të personit të dyshuar / i akuzuar. Ai gjithashtu kërkon që Shtetet Anëtare të miratojnë masa që parandalojnë bërjen, nga autoritetet publike, e deklaratave publike që cilësojnë një personi të dyshuar / akuzuar si fajtor para se ai të shpallet i tillë me ligj. Duhet të merren gjithashtu masa për të siguruar që të dyshuarit / personat e akuzuar të mos paraqiten si fajtorë në publik ose gjatë paraqitjeve në gjykatë përmes përdorimit të kufizimeve.
- 1.2 Më tej, Direktiva e Prezumimit të Pafajësisë njuh të drejtën për të heshtur dhe të drejtën për të mos inkriminuar veten. Ajo njuh gjithashtu të drejtën për të mos pasur pasoja negative nga ushtrimi i së drejtës për të heshtur. Sidoqoftë, dihet që sjellja 'bashkëpunuese' nga ana e të dyshuarve dhe personave të akuzuar mund të merret në konsideratë kur vendoset masa e dënimit

- 1.3 Së fundmi, Direktiva pohon se të dyshuarit dhe personat e akuzuar kanë të drejtë të jenë të pranishëm në gjyqin që do të përcaktojnë fajësinë apo pafajësinë e tyre.

2 Prezumimi i pafajësisë në ligjin shqiptar

- 2.1 Prezumimi i pafajësisë është një e drejtë kushtetuese sipas ligjit shqiptar,¹⁰⁷ dhe njihet në KPP.¹⁰⁸

Paraqitja si fajtorë në publik

- 2.2 Nuk ka asnjë dispozitë të përgjithshme në ligjin shqiptar që ndalon zyrtarët publikë t'i referohen publikisht një personi të dyshuar/akuzuar si fajtor para se ai të shpallet i tillë me ligj. Gjithashtu nuk ka rregulla se si autoritetet publike duhet të flasin me mediat në lidhje me procedimet penale.
- 2.3 Sidoqoftë, ekzistojnë rregullore dhe akte të ndryshme të brendshme që kufizojnë lloje të caktuara deklaratash nga profesionistë të drejtësisë penale që cënojnë prezumimin e pafajësisë:
- Gjyqtarët dhe Prokurorët u nënshtrohen disa kufizimeve mbi informacionin dhe opinionet që mund të bëjnë publike. Për shembull, gjyqtarët nuk duhet të ndajnë informacione, të bëjnë deklaratat, ose të japin hapur opinione mbi çështjet gjyqësore para se të merret një vendim zyrtar përfundimtar.¹⁰⁹ Prokurorëve u kërkohet të tregojnë kujdes kur shprehin mendimet dhe opinionet e tyre personale mbi gjyqtarët, dëshmitarët dhe të pandehurit, veç rasteve kur këto deklaratat bëhen për të treguar mënyrën si duhet zbatuar ligjit.¹¹⁰ Mospërbushjet e këtyre detyrimeve konsiderohen shkelje disiplinore.
 - Policia Gjyqësore¹¹¹ dhe Policia e Shtetit¹¹² u nënshtrohen gjithashtu kufizimeve në informacionet që mund të ndajnë. Policia e Shtetit nuk lejohet të bëjë deklaratat publike që shkelin parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mosdiskriminimit dhe dinjitetin e të dyshuarve, viktimave dhe të miturve. By contrast, there are no rules or laws that explicitly prohibit government officials or ministers to respect the presumption of innocence.

¹⁰⁷Neni 30, Kushtetuta e Shqipërisë.

¹⁰⁸Neni 4, KPP.

¹⁰⁹Neni 11, Kodi i etikës i gjyqtarëve.

¹¹⁰Neni 3 i Urdhrit nr. 114/2014 të Prokurorit të Përgjithshëm për miratimin e rregullave të etikës dhe sjelljes së prokurorëve.

¹¹¹Neni 14, Ligji për Policinë Gjyqësore.

¹¹²Neni 77, Ligji për Policinë Gjyqësore

- 2.4 Nga ana tjetër, nuk ka rregulla ose ligje që ndalojnë qartazi zyrtarët qeveritarë ose ministrat të respektojnë prezumimin e pafajësisë.
- 2.5 Avokatët dhe organizatat e shoqërisë civile të konsultuara për këtë studim raportuan se prezumimi i pafajësisë shpesh nuk respektohet nga zyrtarët publikë, veçanërisht nga punonjësit civilë, ministrat, Kryeministri dhe Deputetët. Kjo vihet re kryesisht në çështjet që kanë tërhequr vëmendje publike, ku personat e akuzuar, efektivisht konsiderohen fajtorë nga opinioni publik.

3 Media

- 3.1 Ekzistojnë rregullore në lidhje me detyrimin e mediave për të raportuar mbi krimet dhe procedimet penale pa shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë. Për shembull, Kodi i Transmetimit për Mediat Audiovizive kërkon që ofruesi i shërbimit të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë, por kjo nuk duhet të parandalojë raportimin e duhur të çështjeve me interes publik. Gazetarët gjithashtu i nënshtrohen një Kodit Etik i cili kërkon që raportimi i procedurave gjyqësore (përfshirë publikimin e imazheve dhe transmetimin e tyre) duhet të jetë i saktë, i drejtë, joparagjykses, dhe të respektojë plotësisht të drejtën për një gjykim të drejtë. Gazetarët gjithmonë duhet të respektojnë prezumimin e pafajësisë dhe ata nuk duhet të përshkruajnë dikë si një kriminel para se të ketë një vendim përfundimtar gjykate. Ankesat në lidhje me shkeljen e prezumimit të pafajësisë nga organet e medias mund të ngrihen përpara Autoritetit të Mediave Audio-vizuale, Këshillit Shqiptar të Mediave dhe Gjykatave Penale dhe Civile.
- 3.2 Rezultojnë shkelje të shpeshta të prezumimit të pafajësisë nga organet e medias. Gjatë 6 muajve të fundit të vitit 2018, Këshilli Shqiptar i Medias monitoroi 40 media online për shkelje të kodit të etikës dhe gjeti 353 shkelje në lidhje me raportimin mbi procedurat gjyqësore dhe prezumimin e pafajësisë.¹¹³

4 Paraqitja e të dyshuarve

- 4.1 Të dyshuarit dhe personat e akuzuar shpesh kufizohen fizikisht gjatë gjykimeve. Ata shoqërohen në gjykatë në pranga, dhe në disa raste, kjo pasqyrohet edhe nga media. Gjatë procesit gjyqësor, personi i dyshuar / i akuzuar zakonisht vendoset në kafaz me shufra hekuri ose kuti xhami (kafazet në sallat e gjyqit, vitet e fundit janë zëvendësuar gradualisht me kutitë e xhamit). Është gjithashtu praktikë e zakonshme që personat e akuzuar/ dyshuar të shfaqen në publik me pranga ose byrzylykë elektronikë për arsye sigurie.
- 4.2 Sipas KPP-së, një i pandehur merr pjesë në procedimet gjyqësore si një person i lirë, edhe kur është në paraburgim. Masat kufizuese të sigurisë të tilla si përdorimi i prangave dhe kafazeve të hekurit apo kutive të xhamit supozohet të jenë përjashtime nga ky rregull dhe janë të ligjshme vetëm kur kërkohen për të parandaluar arratisjen e personit ose për të parandaluar dhunën.¹¹⁴ Megjithatë, sipas avokatëve të konsultuar në këtë studim, këto masa zbatohen në shumicën e procedimeve penale, pavarësisht sa i rrezikshëm perceptohet individi, dhe sa e rëndë është vepra që pretendohet të kenë kryer. Kjo përbën shkelje si të KPP¹¹⁵ ashtu edhe të Direktivës së Prezumimit të Pafajësisë.¹¹⁶
- 4.3 Gjithashtu u ngritën shqetësime se kutitë e xhamit kompromentojnë të drejtat e mbrojtjes, pasi vështirësojnë komunikimin mes të dyshuarit/ personit të akuzuar dhe avokatit të tij gjatë gjykimit.

¹¹³<http://kshm.al/2019/01/29/kshm-publikon-shkeljet-e-etikes-ne-mediat-online/>

¹¹⁴Neni 344, KPP

¹¹⁵Neni 344, KPP

¹¹⁶Neni 5 i Direktivës së Prezumimit të Pafajësisë

5 E drejta për të heshtur dhe për të mos inkriminuar veten

- 5.1 Të drejtat për të heshtur dhe për të mos inkriminuar veten njihen qartë në ligjin shqiptar. Neni 34a (c) i KPP-së, në veçanti, njeh të drejtën për të heshtur, si dhe të drejtën për të mos iu përgjigjur pyetjeve të caktuara. I pandehuri informohet në Letrën e të Drejtave për të drejtën për të heshtur para se të merret në pyetje për herë të parë, ose para kryerjes së veprimeve të tjera procedurale në të cilat kërkohet prania e të pandehurit.¹¹⁷ Në rastet e arrestimit ose ndalimit, oficeri i policisë gjyqësore njofton personin e ndaluar / arrestuar se ai nuk ka asnjë detyrim për të bërë deklaratë dhe se gjithçka që thotë mund të përdoret kundër tij në gjykim.¹¹⁸
- 5.2 Sipas nenit 37 të KPP-së,¹¹⁹ deklaratat inkriminuese të bëra nga një individ para se të akuzohet zyrtarisht nuk mund të përdoren kundër tij. Në këto raste, autoriteti procedues ndërpret pyetjen dhe informon personin për pasojat e deklaratave të tilla dhe mbi të drejtën e tij për t'u mbrojtur nga një avokat.
- 5.3 Avokatët e intervistuar për këtë studim raportuan se prokurorët ndonjëherë u bëjnë presion personave të dyshuar dhe akuzuarve që të mos heshtin, duke i akuzuar ata për mungesë bashkëpunimi, ose edhe duke i kërcënuar ata. Të dyshuarit dhe personat e akuzuar janë kërcënuar se do të akuzohen për vepra të tjera penale si 'refuzim për të dëshmuar', 'deklaratë të rreme para prokurorisë / policisë gjyqësore' ose për " moskallëzim krimi".
- 5.4 Më tej, KPP ofron mundësinë e nënshkrimit të një marrëveshje bashkëpunimi me prokurorinë, sipas së cilës i dyshuari ose personi i akuzuar siguron informacion të rëndësishëm për prokurorinë në lidhje me veprat penale që mund t'i inkriminojnë ata. Në këto raste, prokuroria mund të kërkojë nga gjykata të ulë masën e dënimit ose të përjashtojë plotësisht personin nga dënimi.¹²⁰ Këto ligje mund të kenë një ndikim negativ në ushtrimin e lirë të së drejtës për të heshtur, pasi ato incentivojnë të

dyshuarit dhe personat e akuzuar të rrëfejnë dhe madje edhe të inkriminojnë veten (edhe nëse janë të pafajshëm).

6 Gjyqi në mungesë

- 6.1 KPP lejon që, në rrethana të caktuara, një person i dyshuar / i akuzuar të gjykohet në mungesë. Nëse i pandehuri nuk mund të gjendet pavarësisht përpjekjeve të bëra nga policia gjyqësore, gjykata mund të pezullojë gjykimin deri në një vit dhe të urdhërojë policinë gjyqësore të vazhdojë kërkimin e të pandehurit.
- 6.2 Gjykimet mund të zhvillohen në mungesë të të pandehurit, por në prani të një avokati, nëse:
1. i pandehuri nuk mund të gjendet pas një viti;
 2. i pandehuri dihet që i fshihet qëllimisht drejtësisë; ose
 3. i pandehuri ndodhet jashtë vendit dhe nuk mund të ekstradohet në Shqipëri.¹²¹
- 6.3 Nëse i pandehuri shfaqet pas fillimit të procedurave në mungesë, gjykata revokon vendimin e saj për të kryer gjyqin në mungesë. Kur i pandehuri paraqitet pasi shqyrtimi gjyqësor është deklaruar i mbyllur, por vendimi përfundimtar nuk është marrë ende, ai mund të kërkojë të merret në pyetje. Veprimet e kryera më parë mbeten të vlefshme, por kur kërkohet nga i pandehuri, gjykata mund të vendosë riçeljen e shqyrtimit gjyqësor, marrjen e provave nga i pandehuri ose përsëritjen e veprimeve procedurale.¹²² Në përputhje me Direktivën e prezumimit të pafajësisë,¹²³ KPP përcakton që nëse personi është gjykuar në mungesë duke rezultuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë, ligji kërkon rigjykimin e çështjes. Kërkesa për rigjykim duhet të dorëzohet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Kërkesat e paraqitura brenda këtij afati nuk mund të refuzohen nga gjykata.¹²⁴

¹¹⁷Neni 34a / 2, KPP.

¹¹⁸Neni 255/1, KPP.

¹¹⁹Neni 37, KPP.

¹²⁰Neni 37 / a, KPP.

¹²¹Neni 352, KPP.

¹²²Neni 352, KPP.

¹²³Neni 9 i Direktivës së Prezimit të Pafajësisë.

¹²⁴Neni 450, KPP

- 6.5 Gjykimet në mungesë nuk mund të zhvillohen për të pandehurit e mitur. Në këto raste, gjykata pezullon gjykimin për një kohë të pacaktuar pas kërkimeve fillestare për vendndodhjen e të pandehurit.¹²⁵
- 6.6 Lidhur me përpjekjet e arsyeshme që duhet të bëhen për të gjetur individin, njoftimi i të pandehurit bëhet duke i paraqitur personalisht një kopje të aktit së bashku me Letrën e të Drejtave. Kur këto nuk mund t'i dorëzohen personalisht individit, njoftimi bëhet në vendin ku ata jetojnë ose punojnë, duke ia dorëzuar aktin një personi bashkëjetues, një fqinji ose një personi që punon me ta. Nëse i pandehuri është i mitur, ata do të njoftohen përmes prindit ose kujdestarit të tyre, si dhe sipas legjislacionit të veçantë mbi të miturit.¹²⁶ Kur personat e përmendur më lart mungojnë, janë të përshtatshëm, ose refuzojnë të marrin aktin, kërkimi i të pandehurit vazhdon. Nëse është e pamundur të bëhet njoftimi në këtë mënyrë, akti depozitohet në qendrën administrative të lagjes ose fshatit ku banon ose punon i pandehuri. Njoftimi i dorëzimit vendoset në portën e shtëpisë së të pandehurit ose në vendin ku ata punojnë, në tabelën e njoftimeve të gjykatës dhe në faqen e internetit të gjykatave.

7 Rekomandime

- 7.1 Parimet e përgjithshme të prezumimit të pafajësisë ripohohen në Kushtetutën Shqiptare dhe Kodin e Procedurës Penale, ku përfshihet e drejta për të heshtur. Sidoqoftë, dispozitat në lidhje me aspektet specifike të prezumimit të pafajësisë në Direktivën e Prezumimit të Pafajësisë përfshirë moslejimin e deklarimeve publike të fajësisë dhe përdorimin e kufizimeve fizike, duket se janë transpozuar në mënyrë joadekuate dhe / ose janë zbatuar dobët.
- Kufizimet për deklaratat publike dhe referimi publik si fajtor**
- 7.2 Duhet të ketë një ndalim të qartë ligjor për referenca publike të fajësisë të bëra nga autoritetet publike, duke përfshirë gjyqtarët, prokurorët, ministrat, kryeministrin, deputetët dhe nëpunësit publik.
- 7.3 Duhet të ketë kufizime ligjore për deklaratat e bëra nga autoritetet publike (gjykatës, prokurorë, ministra, kryeministërdeputetë, nëpunës publik) dhe mediat në lidhje me procedimet penale për të siguruar që deklarata të tilla nuk shkelin prezumimin e pafajësisë.
- 7.4 Organet rregullatore të mediave duhet të jenë të autorizuar për të monitoruar dhe hetuar shkeljet e prezumimit të pafajësisë në mënyrë më aktive.
- 7.5 Gazetarët duhet të trajnohen për të drejtat e njeriut dhe raportimin etik të krimeve dhe procedurave gjyqësore.
- Përdorimi i kufizimeve në publik**
- 7.6 Duhet të ketë standarde më të rrepta dhe udhëzime më specifike për përdorimin e kufizimeve fizike, në mënyrë që ato të zbatohen vetëm për arsye sigurie.

¹²⁵Neni 352, KPP.

¹²⁶Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.

Pjesa 5:

Direktiva e të miturve

1 Direktiva (EU) 2016/800 për masat mbrojtëse procedurale për të miturit e dyshuar dhe akuzuar në proçimet penale ('Direktiva e të Miturve')

- 1.1 Direktiva e të Miturve parashtrohet rregullat e përbashkëta minimale për të drejtat e të miturve të akuzuar dhe të dyshuar në procedura penale. Ajo njeh se cdo çdo fëmi që përballet me sistemin e drejtësisë penale ka nevoja të veçanta dhe se identifikimi dhe plotësimi i tyre përcakton shtrirjen e aftësisë së secilit për t'u bërë pjesë e efektshme e procedurës penale, dhe për të marrë gjykim të rregullt. Të drejtat e të miturve të dyshuar dhe akuzuar shkojnë përtej të drejtave që gëzojnë në përgjithësi personat e dyshuar/akuzuar.
- 1.2 Për shembull, të miturve të pandehur u duhet dhënë ndihma juridike e nevojshme që u jep mundësinë të përgatisin dhe paraqesin mbrojtjen. Prezenca e një avokati gjatë procedimit penal përbën masë mbrojtjeje të rëndësishme kundër shkeljes së të drejtave procedurale. Në bazë të Nenit 6 të Direktivës së të Miturve, Vendet Anëtare duhet të sigurojnë që të miturit e dyshuar dhe të akuzuar kanë qasje në ndihme juridike, si dhe të sigurojnë që ndihmohen nga një avokat.
- 1.3 Me tej, standartet ndërkombëtare kërkojnë që të miturit të kenë të drejtën të dëgjohen për të gjitha çështjet që i shqetësojnë dhe këto standarte sigurisht zbatohen dhe për të miturit e dyshuar për vepër penale.

Mbrojtja e privatësisë së të miturit e akuzuar gjatë procedimit penal është veçanërisht e rëndësishme për të evituar dëme që mund të shkaktojë publiciteti i tepërt ose procesi i etiketimit. Gjithashtu, edhe pse në disa raste burgosja e të miturit së akuzuar mund të jetë e nevojshme, kjo masë duhet të konsiderohet si opsioni i fundit, dhe duhet shoqëruar me dispozita të veçanta që mbrojnë plotësisht interesat më të larta të të miturit kur ndalohet ose kur merren masa alternative .

- 1.4 Ekzistenca e mënyrave të shumta për të trajtuar ndryshe fëmijët e akuzuar nga të akuzuarit e rritur, si dhe aftësitë e veçanta që nevoiten për të komunikuar efektshëm me të mitur të akuzuar, tregon që të drejtat e të miturve mund të mbrohen më mirë nga ekspertët të specializuar për këto aspekte. Një nga problemet që Fair Trials ka identifikuar është fakti se dhe pse shumë vende kanë sisteme që sigurojnë qasjen në avokat për të mitur të dyshuar/akuzuar, jo të gjithë avokatët kanë trainimin e specializuar apo aftësi të veçanta që sigurojnë një përfaqësim juridik të efektshëm.

2 Pamje e përgjithshme e Sistemit të Drejtësisë për të Mitur

- 2.1 Në 2017, Parlamenti i Shqipërisë miratoi [Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur nr.37/2017 \('KDPM'\)](#), i cili shtroi rrugën për një sistem të ri drejtësie për të miturit në Shqipëri të bazuar, ndër të tjera, mbi parimet e mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturit, mbrojtjes nga diskriminimi, dhe të drejtën për tu dëgjuar. KDPM-ja hyri në fuqi në Janar të 2018, u bazua gjerësisht në Direktivën për të Mitur, dhe i referohet Konventës së OKB-së për të drejtat e të miturit. KDPM përforcon të gjitha dispozitat mbi të miturit të KPP-së, Kodit Civil dhe Ligjit për të Drejtat dhe Trajtimim e të dënuarve me burgim dhe personave në paraburgim. and Detainees.

- 2.2 KDPM-ja ka përmirësuar ndjeshëm mbrojtjen e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin. Megjithatë, zbatimi në praktike i standarteve të kërkuara mbetet sfidë.
- 2.2 Në Shqipëri, moshë minimale e përgjegjësisë penale është 14 vjeç, për të mitur që kanë mbushur këtë moshë në kohën e kryerjes së krimit, dhe 16 vjeç për të mitur që kryejnë kundravajtje në bazë të Kodit Penal. KDPM-ja aplikohet dhe për persona midis moshës 18 dhe 21 vjeç, nëse i akuzuari ishte i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale. Këta individë kualifikohen si “të rinj”,¹²⁷ dhe mund të të gjykohen në seksionet për të mitur të gjykatave deri në moshën 23 vjeç.¹²⁸ Në bazë të KDPM-së, të miturit duhet të gjykohen nga seksionet penale për të mitur të gjykatave të rretheve gjyqësore.¹²⁹ Shqipëria ka 7 seksione të tilla që mbulojnë 23 rrethe gjyqësore.¹³⁰ Ligji përcakton që Gjykatësit në seksionet për të mitur të jenë të specializuar dhe trajnuar në çështjet e drejtësisë për të mitur.¹³¹
- 2.3 Për të lehtësuar qasjen në të dhëna mbi të miturit në konflikt me ligjin, Këshilli i Ministrave miratoi një vendim të ri¹³² për krijimin e “Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë për të Mitur”. Sistemi bën shpërndarjen dhe përditësimin e të dhënave të drejtësisë për të mitur dhe synon mbledhjen e menjëherëshme të tyre, të përmirësojë qasjen në drejtësi dhe administrimin e sistemit të drejtësisë për të mitur, të koordinojë bashkëpunimin ndër-institucional, dhe të unifikojë dhe kompjuterizojë të dhënat e drejtësisë për të mitur që ndihmojnë për analizën dhe përmirësimin e politikave për drejtësinë penale për të mitur.

3 Statistics

- 3.1 Statistikat për drejtësinë për të mitur, për këtë studim, u siguruan nga Ministria e Drejtësisë Shqiptare.¹³³ Në 2018, 195 të mitur u dënuan për

krime, krahasuar me 410 në 2015. Në 2016, 464 të mitur u dënuan me deri në 2 vjet burg dhe 176 me 2-5 vjet burg. Me hyrje në fuqi të KDPM-së numrat janë zvogëluar ndjeshëm gjatë viteve të fundit.

- 3.2 Sipas të dhënave, numri i të miturve në konflikt me ligjin për krime është më i lartë se i atyre për kundravajtje. Kjo mund të jetë pasojë e ndryshimeve të politikave të Drejtësisë Penale që kategorizojnë më shumë vepra penale si krime.
- 3.3 Statistikat gjithashtu tregojnë se numri i të miturve meshkuj të dënuar për krime është shumë i lartë krahasuar me atë të të miturve femra që është shumë i ulët. Femrat e mitura që kryejnë krime burgosen bashkë me të rriturat në të vetmin burg për femra në vend. Për arsye të numrit të vogël të femrave të mitura në burg, nuk ka një institucion të posaçëm për to.

4 Ndhima me Avokat

- 4.1 Të miturit e dyshuar dhe të akuzuar duhet të ndihmohen gjithmonë me avokat që në fazat e para të procesit të drejtësisë penale (p.sh. gjatë arrestimit nga policia), për të siguruar ushtrimin e efektshëm të të drejtave të tyre. Në përputhje me Direktivën për të Mitur, KDPM-ja bën të detyrueshme praninë e avokatit në të gjithë veprimet procedurale që kanë të bëjnë me të mitur. Studimet kanë zbuluar se e drejta e qasjes në avokat që në fillim të procedurës (marrja në pyetje nga policia) përgjithësisht respektohet në praktikë.¹³⁴ Edhe pse KDPM-ja kërkon që të miturit të ndihmohen nga avokatë të specializuar,¹³⁵ është e dukshme që jo të gjithë të miturit kanë qasje në avokat të specializuar për të drejtat e të miturve

¹²⁷Në këtë raport termat "fëmijë", "i mitur" dhe "i ri" përdoren si sinonime.

¹²⁸Neni 23/6, KDPM.

¹²⁹Neni 27/1, KDPM.

¹³⁰Dekreti i Presidentit Nr.6218, datë 7.7.2009.

¹³¹Neni 27/3, KDPM.

¹³²VKM nr. 149 datë 20.03.2019.

¹³³Statistikat e siguruar nga Ministria e Drejtësisë, përmes një kërkesë informacioni nr. 4131, datë 20.5. 2019.ts

¹³⁴<https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Monitorimi-i-te-drejtave-te-personave-ne-Komisariate-Drejtore-e-Policise-Janar-2019.pdf>

¹³⁵Neni 31, KDPM.

4.2 Në përputhje me Nenin 18 të Direktivës për të Mitur, ligji Shqiptar siguron ndihmë juridike për të mitur.¹³⁶ Të miturit mund të kërkojnë ndihmë juridike nëpërmjet formularëve miratuar rishtazi nga Ministria e Drejtësisë.¹³⁷ Sidoqoftë, i njëjti formular përdoret për të gjithë personat e dyshuar apo të akuzuar, dhe nuk ka version të posaçëm për të mitur. Dështimi për ti bërë formularët për ndihmë juridike më të përshtatshme për të mitur, duke përdorur gjuhë më të thjeshtë e vështirëson shumë procesin e kërkesës për ndihmë. Edhe pse këto formularë u publikuan rishtazi në faqen e Ministrisë së Drejtësisë, ato nuk njihen mirë nga publiku i gjërë.¹³⁸ Kjo mungesë informimi rezulton në shfrytëzim të ulët të ndihmës juridike gjë që saboton aksesin në drejtësi. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, nuk ka kërkesa për ndihmë juridike nga të mitur në çështje penale ndërmjet Janarit 2015-Prill 2019.¹³⁹

4.3 Sipas KDPM-së, përfaqësimi i të miturit në gjykatë nga një avokat ekspert është i detyrueshëm.¹⁴⁰ Por, nuk ka mekanizma të efektshëm për identifikimin e avokatëve ekspert. Rajonet e policisë, gjykatat, dhe prokuroria nuk kanë në dispozicion lista ekspertësh të specializuar.¹⁴¹

5 Marrja në pyetje dhe regjistrimi audio-vizual i marrjes në pyetje të të miturit të dyshuar apo akuzuar.

5.1 Rregullat për marrjen në pyetje të të miturit në Shqipëri ndryshojnë pjesërisht nga rregullat minimale që përcakton Direktiva për të Miturit. Në bazë të Nenit 9 të Direktivës, Vendet Anëtare sigurojnë që marrja në pyetje e të miturit nga policia ose autoritet tjetër ligjvënës regjistrohet audio-vizualisht kur është proporcionale me rrethanat. Në bazë të ligjit Shqiptar, regjistrimet audio-vizuale të marrjes në pyetje janë të detyrueshëm vetëm për të mitur që janë viktimë dhe/ose dëshmitarë (veçanërisht për dhunë ose shfrytëzim seksual)¹⁴²

5.2 Kjo dispozitë nuk zbatohet për të mitur të dyshuar apo akuzuar në procedim penal.¹⁴³ Në praktikë, mbahet vetëm procesverballi. Sidoqoftë, ka garanci të tjera procedurale për marrjen në pyetje të të miturit të dyshuar apo akuzuar.¹⁴⁴ Në veçanti, trupi i akuzës konsultohet me psikologun mbi përmbajtjen e pyetjeve për të miturin, për ta ndërtuar pyetjen sa më përshtatshëm për të lehtësuar dhënien e dëshmisë nga i mituri dhe për të evituar frikëngjalljen gjatë procesit. Gjuha që përdoret gjatë marrjes në pyetje duhet të jetë shumë miqësore dhe komunikimi sa më i qartë të jetë e mundur

5.3 Kushtet e procesit të marrjes në pyetje përfshijnë ndërprerje me kërkesë të të miturit, përfaqësuesit juridik ose psikologut dhe ndalimi i marrjes në pyetje gjatë natës. Nuk ka kufizime me ligj ose në praktikë mbi kohëzgjatjen ose herët që i mituri i dyshuar dhe i akuzuar mund të merret në pyetje.

5.4 Sipas organizatave për të drejtat e të miturve që u intervistuan për këtë studim, rritet mundësia që të miturit të inkriminojnë veten e tyre nëse janë marrë në pyetje shumë herë. Ndonjëherë, përsëritja e marrjes në pyetje ndodh si shkak i parregullsive dhe mungesës së regjistrimit të herës së parë të marrjes në pyetje. Gjithashtu, ka pasur parregullsira dhe me regjistrimet e marrjes në pyetje nga policia.

5.5 Avokatët e konsultuar për këtë studim raportojnë gjithashtu raste të shumta të shkeljes së procedurës dhe trajtimit të posaçëm gjatë marrjes në pyetje, përfshirë tejzgjatje të procesit, dhe diskutimi i çështjeve të parëndësishme ose të papërshtatshme në praninë e të miturit. Të miturit ndonjëherë ndryshojnë dëshminë nën influencën e prindërve ose të oficerit të policisë gjyqësore

¹³⁶Neni 36, KDPM.

¹³⁷<https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/04/URDHER-Nr.225-date-25.3.2019-PER-MIRATIMIN-E-FORMULAREVE-TE-NDIHMES-JURIDIKE-TE-GARAN-TUAR-NGA-SHTETI.pdf>.

¹³⁸https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/12/Raport-Ndihma-Juridike-per-publikim-_Komiteti-Shqiptar-i-Helsinkit.pdf.

¹³⁹Informacioni i dhënë nga Ministria e Drejtësisë, në përgjigje të kërkesës për informacion nr 4131, 20.5.2019; <https://www.unicef.org/albania/child-friendly-justice>.

¹⁴⁰Neni 31, KDPM.

¹⁴¹Mbljedhja e Mekanizmit Institucional për Zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, 12 Nëntor 2019.

¹⁴²Neni 39, 41, KDPM.

¹⁴³Neni 76, KDPM.

¹⁴⁴Neni 77, KDPM.

- 5.6 Janë bërë përpjekje për të siguruar që të miturit të merren në pyetje në hapësira miqësore për ta. Në bazë të Urdhërit Nr.715, i 5 Qershor 2019 rajonet e Policë kanë krijuar “Njësi për marrjen në pyetje të të Miturve”. Bazuar në këtë urdhër dhe me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile, disa rajone policie kanë krijuar ambiente të veçanta për marrjen në pyetje të të miturve.¹⁴⁵
- 5.7 Sidoqoftë, edhe në rajone policie të pajisur me hapësira miqësore për të miturit, organizatat për të drejtën e të miturve deklarojnë se ka mungesë të përgjithshme vullneti nga policia për të përdorur këto hapsira, dhe se ata preferojnë t’i marrin të miturit në pyetje në zyrat e policisë gjyqësore në ambiente për të rritur.

6 E drejta për vlerësim individual

- 6.1 Vlerësimi individual është një procedurë që duhet ndërmarrë kur merren vendime për një të mitur. Kriteret që përcakton KDMP-ja në Shqipëri janë të ngjashme me dispozitat e Direktivës për të Mitur dhe përfshin moshën, nivelin e zhvillimit, kushtet e jetesës, edukimin dhe zhvillimin, shkollimin, kushtet shëndetësore, situatën familiare dhe rrethana të tjera që mundësojnë vlerësimin individual. Sidoqoftë, ka paqartësira se kur duhet të bëhet vlerësimi. Direktiva për të Mitur thotë se vlerësimi duhet të bëhet në rastin e parë të përshtatshëm të procedimit dhe përpara dhënies së vendimit, po në asnjë rast pas fillimit të seancave dëgjimore në gjykatë.¹⁴⁶ Në Shqipëri, gjykata dhe prokuroria kanë përgjegjësinë për kryerjen e vlerësimeve individuale. Këto dy trupa mund të kërkojnë, kur është e nevojshme, kryerjen e vlerësimit individual të shëndetit, familjes, kushteve sociale dhe mjedisore të të miturit, nga një ekspert ose grup ekspertësh të fushave të ndryshme, me qëllim që të kuptojnë personalitetin, besueshmërinë dhe shtrirjen e përgjegjësisë së tij.¹⁴⁷

- 6.2 Vlerësimi individual i të miturit përcakton nevojat e veçanta të të miturit, probabilitetin që i mituri të kryejë vepër penale si dhe faktorë të tjerë sipas rastit, si dhe rekomandon masat e posaçme që duhen marrë për zhvillimin dhe integrimin e të miturit në shoqëri. Vlerësimi individual është i detyrueshëm kur:

1. imponohet masë alternative në vend të procedimit penale;
2. Është vendosur mënyra e paraburgimit;
3. është ekzekutuar vendimi i dënimit; dhe
4. është vlerësuar kërkesa për lirim me kusht.¹⁴⁸

- 6.3 Sipas Direktivës për të Mitur, vlerësimi duhet të kryhet me qasje shumëfushore nga personel i kualifikuar dhe, kur është e përshtatshme, në praninë e mbajtësit të përgjegjësishë prindërore dhe/ose të ekspertit. KDPM-ja nuk përcakton metodën për kryerjen e vlerësimit por përcakton institucionet përgjegjëse. Në rastet “1” dhe “2” më sipër, për vlerësimin e detyrueshëm, vlerësimi kryhet nga eksperti/grup ekspertësh ose nga Shërbimi i Proves, dhe në rastet “3” dhe “4”, vlerësimi përgatitet nga Shërbimi i Burgut (nga institucioni ku i mituri po vuan dënimin) dhe/ose Shërbimi i Provës. Kur është e përshtatshme, organizmat e sipërpërmendur marrin në konsideratë mendimin e Njesisë për Mbrojtjen e të drejtave të të miturit¹⁴⁹ gjatë përgatitjes së raportit të vlerësimit individual.

¹⁴⁵Mbljedhja e Mekanizmit Institucional për Zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, 12 Nëntor 2019.

¹⁴⁶Neni 7 i Direktivës për të Mitur.

¹⁴⁷Neni 22, KDPM.

¹⁴⁸Neni 47, KDPM.

¹⁴⁹Këto organizma krijohen në nivel bashkie dhe janë përgjegjës për të gjithë të miturit nën juridiksionin e bashkisë.

6.4 KDPM-ja shkon përtej Direktivës në lidhje me personat e përfshirë në vlerësim individual, dhe përcakton që ekspertët përgjegjës mund të marrin informacionin e nevojshëm nga çdo person fizik dhe/ose juridik (publik dhe/ose privat) që mendohet të ndihmojë procesin.

6.5 Me hyrjen në fuqi të KDPM-së në Janar 2018, vlerësimi individual u bë i detyrueshëm. Të dhëna nga Shërbimi i Provës tregojnë se gjatë vitit 2018 janë përgatitur 48 vlerësime individuale të gjitha me kërkesë të gjykatës. Në 2019, numri i vlerësimeve ishte 70 nga të cilat (69) me kërkesë të gjykatës dhe (1) me kërkesë të prokurorisë.¹⁵⁰ Më shumë vlerësime individuale përgatiten nga ekspertë privat se nga institucionet shtetërore.¹⁵¹ Raportet e përgatitura nga ekspertë privat paguhen nga personat e dyshuar/akuzuar ose nga shteti.

7 E drejta për ekzaminim mjekësor

7.1 Në përputhje me Direktivën për të Mitur, legjislacioni Shqiptar njeh të drejtën për ekzaminim mjekësor për të miturit në heqje lirie.¹⁵² I mituri ka të drejtën për ekzaminim mjekësor që në fazat fillestare të procedimit penal. Ekzaminimi kryhet në rajonin e policisë ku i mituri dërgohet pas arrestit. Autoritetet përkatëse, si gjykatat dhe prokuroria mund të kërkojnë, sipas nevojës dhe rastit, ekzaminime më të detajuara dhe më të specializuara.

7.2 Megjithatë në praktikë, të miturit nuk u nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore të përshtatshme dhe të menjëherëshme. Rajonet e Policisë nuk kanë doktor, dhe ekzaminimet shpesh janë të papërshtatshme dhe të paplota.¹⁵³

Mbajtësit e përgjegjësishë prindërore dhe

8 përfaqësuesi juridik

8.1 Mbajtësit e përgjegjësishë prindërore në Shqipëri konsiderohen përfaqësues juridik të të miturit. Si pasojë, ligji Shqiptar kërkon praninë e tyre në të gjitha etapet e procedimit penal, përfshirë dhe marrjen në pyetje nga policia. I mituri ka të drejtën të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në lidhje me të, direkt dhe/ose nëpërmjet përfaqësuesit juridik.¹⁵⁴ Gjithashtu, në bazë të Nenit 49 të KDPM-së, prania e përfaqësuesit juridik është e detyrueshme në akte procedurale që kanë të bëjnë me të miturin. Gjatë investigimit dhe gjyqit, prokurori dhe gjykatësi mund të ndalojë përfaqësuesin juridik të të miturit në konflikt me ligjin të marrë pjesë në procedim vetëm kur kjo është në interesin më të lartë të të miturit.¹⁵⁵

8.2 Kjo dispozitë është e ngjashme me dispozitën e Direktivës për të Mitur. Neni 15 i Direktivës kërkon praninë e mbajtësit të përgjegjësishë prindërore gjatë seancave dëgjimore. Direktiva kërkon gjithashtu praninë e mbajtësit të përgjegjësishë prindërore gjatë etapave të tjera të procedimit nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit dhe nëse prania e tyre nuk çënon procedimin penal.

8.3 Të miturve të arrestuar u jepet ndihmë psiko-sociale. Ndihma jepet nga psikologë të punësuar në institucione, shkolla të zonës, ose organizata vendase jofitimprurëse. Për shembull, Drejtoria Rajonale e Policisë në Tiranë ka nënshtuar një marrëveshje me një organizatë vendase që i siguron asaj një psikolog apo punëtor social për të gjitha rastet dhe procedurat me të mitur. Sidoqoftë, kjo organizatë ka personel të kufizuar dhe 2 psikologë mbulojnë 6 rajone policie. Secili prej 12 rajoneve të policisë ka në dispozicion vetëm një psikolog.¹⁵⁶

¹⁵⁰Informacion i dhënë nga Shërbimi i Provës, në përgjigje të kërkesës për informacion nr. 1594, datë 17.01.2020.

¹⁵¹Informacion i dhënë nga Ministria e Drejtësisë, në përgjigje të kërkesës për informacion nr. 1018 datë 13.12.2019.

¹⁵²Neni 8 i Direktivës për të Mitur dhe Neni 79 i KDPM-së.

¹⁵³https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Monitorimi-i-te-drejtave-te-personave-ne-Komisariate_Drejtore-e-Policise_Janar-2019.pdf.

¹⁵⁴Neni 16, KDPM.

¹⁵⁵Neni 49, KDPM.

¹⁵⁶Informacion i dhënë nga Policia e Shtetit, në përgjigje të kërkesës për informacion të datës 27.6.2019.

8.4 Ekspertët e konsultuar për këtë studim thonë se ndihma e psikologut zakonisht është në dispozicion, por ka patur raste kur të miturit janë marrë në pyetje në mungesë të tyre. Janë raportuar dhe raste kur psikologët nënshkruajnë regjistrin sikur ata të ishin të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (edhe pse mungonin).¹⁵⁷ Për më tepër, avokatët e intervistuar për këtë studim kanë thënë se ka patur shumë raste të raportuara ku mbi të miturin është bërë presion për t'iu përgjigjur pyetjeve të policisë pa praninë e një të rrituri (mbajtësi i përgjegjësishë prindërore), psikologu apo avokati.

9 E drejta e të miturve për t'u paraqitur personalisht dhe marrë pjesë në gjykimin e tyre

9.1

Në përputhje me Nenin 16 të Direktivës për të Mitur, KDPM'ja njeh të drejtën për pjesëmarrje në gjykim si dhe të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar dhe shprehur mendimin e tij (duke marrë në konsideratë moshën dhe pjekurinë e tij). Ligji Shqiptar nuk kërkon që i mituri të jetë pranishëm në të gjithë etapat e procedimit penal. Megjithatë, KDPM thotë se mospjesëmarrja e të miturit nuk duhet të përkeqësojë situatën e tij dhe/ose të përdoret në disfavorin e tij.¹⁵⁸ Gjykimi, në veçanti, duhet të bëhet në praninë e të miturit. Megjithatë, gjykata (automatikisht apo me kërkesë) mund ta largojë të miturin nga salla e gjyqit gjatë ekzaminimit të provave, nëse kjo është në interesin më të lartë të miturit. Periudhat e mungesës të të miturit në procesin gjyqësor duhet të jenë sa më të shkurtra.

10 Heqja e lirisë

10.1 KDPM-ja thekson evitimin e procedimit penal kurdo që të jetë e mundur, dhe i jep përparësi masave alternative, përfshirë drejtësinë rihabilituese si alternative e heqjes së lirisë. Heqja e lirisë është masa e fundit që duhet marrë kur nuk ka masa të tjera të përshtatshme.¹⁵⁹ Kjo është një risi e KDPM-së e cila ka dhënë rezultate të shpejta në 2 vitet pas hyrjes në fuqi. Në Janar 2020 në burg kishte vetëm

23 të mitur, prej të cilëve vetëm 5 ishin dënuar me burg ndërsa të tjerët ishin në paraburgim.¹⁶⁰ Të miturit vihen në paraburgim vetëm në rastin kur akuzohen për krime të dënueshme me burgim 7 vjetë e lartë. Për krime të dënueshme me burgim 7 vjetë e poshtë, gjykatat duhet të japin dënime alternative. Shërbimi i Provës ka dhënë 144 dënime alternative gjatë periudhës Janar-Qershor 2019.¹⁶¹

10.2 Në Shqipëri, Shërbimi i Burgjeve për të mitur përfshin Institutin e Riedukimit në Kavajë¹⁶² dhe 3 seksione për të mitur në burgjet për të rritur në Korçë, Lezhë dhe Vlorë. Në këto institucione, të miturit në heqje lirie zakonisht (por jo gjithmonë) vendosen në hapësira të veçanta nga të rriturit.¹⁶³ Vizita monitoruese të kryera nga organizata të të drejtave të njeriut si Komiteti Shqiptar i Helsinkit ('KShH'), zbuluan se të miturit nuk veçohen mjaftueshëm nga të rriturit në disa qendra paraburgimi dhe burgje, për shkak të mungesës së infrastrukturës. Për shembull, në burgun e Korçës, gjatë monitorimit u zbulua se të miturit ishin vendosur në të njëjtin kat me të rriturit, të cilët në shumë raste i shtynin të vepronin kunder rregullit dhe sigurisë. KSHH-ja gjithashtu zbuloi se dhe kur të miturit mbahen të veçuar nga të rriturit, ka shqetësime për kushtet e këqia të paraburgimit që nuk plotësojnë standartet bazë për ushqimin, tualetin dhe nevoja të tjera të të miturve.

10.3 Në 2018, Ministria e Drejtësisë për të reduktuar gjasat e recidivizmit tek të miturit në konflikt me ligjin si dhe kontaktet e tyre me të burgosurit e rrituri vendosi të mbledhë të gjithë të miturit në institucionin e Kavajës. Gjendja e të miturve është përmirësuar në këtë institucion, por të miturit nën 18 vjeç të vendosur në Kavajë, klasifikohen si të rinj në moshën 18 vjeç dhe jo në moshën 21 vjeç.¹⁶⁴ Kur mbushin 18 vjeç, ata transferohen në burgje për të rritur.

¹⁵⁷https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Monitorimi-i-te-drejtave-te-personave-ne-Komisariate-Drejtorite-e-Policise_Janar-2019.pdf

¹⁵⁸Neni 16, KDPM.

¹⁵⁹Nenet 14, 86, dhe 94, KDPM.

¹⁶⁰Vizita në Kavajë, 16 Janar 2020.

¹⁶¹Mbledhja e Mekanizmit Institucional për Zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, 12 Nëntor 2019.

¹⁶²Njihën botërisht si 'burgje për të mitur'.

¹⁶³Neni 75, KDPM.

¹⁶⁴Për shembull, si të gjykoresh në seksionin të të mitur të Gjykatës

10.4 Në rast arrestimi të të miturit, gjykata duhet të rishikojë arrestimin brenda 48 orëve.¹⁶⁵ Sipas avokatëve ky afat përgjithësisht respektohet por organizata të të drejtave të të miturit të intervistuar për këtë studim thonë se kanë dijeni për raste vonesash.

10.5 Neni 98 i KDPM-së futi konceptin e “kufizimit të lirisë”. Kufizimi i lirisë është një masë alternative ndaj paraburgimit, i cili e vendos të miturin në një institucion/qendër nën mbikqyrje, pa e larguar atë nga shoqëria ose komuniteti, dhe synon të edukojë dhe rehabilitojë të miturit me anë të programeve të posaçme. Ky institucion parashikohet të jetë gjysëm i hapur dhe të miturit e dënuar në bazë të Nenit 98 të KDMP-së e vendosur aty do të mund të jetojnë në komunitet gjatë ditës por të qëndrojnë natën në institucion. Sidoqoftë, dhe pse kjo dispozitë hyri në fuqi në Janar 2018, gjykatësit aktualisht nuk mund të japin këtë dënim pasi institucioni nuk është ndërtuar ende.

11 E drejta e privatësisë

11.1 Në ngjashmëri me dispozitat përkatëse të Direktivës për të Mitur, KDPM-ja ka dispozita për mbrojtjen e të dhënave personale dhe jetës private të të miturve në konflikt me ligjin. Seancat dëgjimore për të mitur mbahen me dyer të mbyllura. Në praktikë, gjykatat e zbatojnë këtë dispozitë në mënyre strikte, dhe ka fakte që gjykatësit nuk pranojnë as kërkesa për monitorimin e seancave dëgjimore ku i përfshirë është një i mitur si viktimë, i dyshuar apo i akuzuar.¹⁶⁶ Gjykatat mund të ndër marrin masa shtesë për mbrojtjen e privatësisë të të miturit. Identifikimi ose publikimi, në çdo formë, i të dhënave personale të të miturit, është i ndaluar, përveç rasteve kur ligji për mbrojtjen e të dhënave personale parashikon ndryshe. Shkelja e kësaj dispozite përbën shkelje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal. Sidoqoftë, në praktikë, media ka shkelur shpesh këtë dispozitë duke publikuar emrat dhe të dhëna të tjera që identifikojnë të miturin.

12 Trajtimi në kohë dhe me kujdes i çështjes

12.1 KDPM-ja ka vendsour afate të qarta për procedurat dhe gjykimet në gjykatata e niveleve të ndryshme për çështjet e të miturve në konflikt me ligjin. Neni 88 i KDPM-së thotë se gjykime ku është i përfshirë një i mitur në konflikt me ligjin duhet të bëhen pa vonesë dhe të kenë prioritet.

KDPM-ja vendos afatet si më poshtë:

1. Çështja e një të mituri në konflikt me ligjin duhet të dërgohet në gjykatë jo më vonë se 3 muaj pas regjistrimit të emrit në regjister, përveç se kur, gjatë kësaj periudhe, i mituri akuzohet për një vepër tjetër penale ose përfshihet në vepra penale që gjykohen nga Gjykata Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Në këto raste, zbatohen afatet e parashikuar në KPP.
2. Gjykata e Shkallës së Parë duhet të përfundojë shqyrtimin e çështjes brenda afatit më të shkurtër kohor dhe jo më vonë se 6 muaj nga data e dorëzimit të dokumentave në Gjykatë.
3. Gjykata e Apelit duhet të mbyllë çështjen brenda afatit më të shkurtër kohor dhe jo më vonë se 2 muaj nga data e dorëzimit të dokumentave në Gjykatë.
4. Gjykata e Lartë do të shqyrtojë vlefshmërinë ligjore të rekursit dhe do ta gjykojë çështjen sa më shpejt që të jetë e mundur.

12.2 Në pjesën më të madhe të rasteve, këto afate duket të jenë respektuar nga gjykatat. Të miturit në paraburgim në Institutin e Riedukimit në Kavajë qëndrojnë në këtë institucion për një kohë relativisht të shkurtër, nga 2 muaj deri në 2 vjet për të miturit e akuzuar për krime të rënda dhe ata të gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.¹⁶⁷

¹⁶⁵Neni 85, KDPM.

¹⁶⁶Të dhëna nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

¹⁶⁷Njësoj si më lart.

13 Trajnimi

13.1 KDPM-ja përmban një kapitull mbi trajnimin dhe specializimin e autoriteteve kompetente në procesin e drejtësisë penale për të mitur. Nga Janari i 2018, janë trajnuar një numër i shumë ekspertësh duke përfshirë gjykatës, prokurorë, oficerë policie, oficerë prove, etj.

Trajnimi i gjykatësve dhe prokurorëve

13.2 Gjatë vitit akademik 2018-2019, Shkolla e Magjistraturës organizoi 8 trajnime për të drejtat e të miturit në lidhje me Kodin e ri të Drejtësisë për të Mitur dhe ndryshimet ligjore në këtë fushë.¹⁶⁸ Në këto trajnime mund të marrin pjesë gjykatës, prokurorë, zyrëtarë të policisë juridike, avokatë shteti, oficerë të akademisë për siguri etj. Disa nga aktivitetet kryesore të trajnimit u organizuan me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë. Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me programin Shqiptaro-Suedez për drejtësinë për të mitur ka trajnuar në total 52 magjistratë, përfshirë gjykatës dhe prokurorë të cilët do të trajtojnë çështje me të mitur në gjykatat përkatëse. Siç parashtron dhe KDPM-ja, trajnimet kanë mbuluar (pa u kufizuar) të gjitha aspektet e përcaktuara në Nenin 26 të KDPM-së.¹⁶⁹

Trainimi i oficerëve të policisë

13.3 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka një seksion për të mitur dhe dhunën në familje me 3 specialistë. Në 12 drejtoritë vendore të policisë në Shqipëri ka vetëm një specialist për mbrojtjen e të miturit dhe dhunën në familje. Në rajonet e policisë, në varësi të territorit që mbulohet dhe numrit të rasteve, ka nga 1 deri në 3 specialistë për të mitur dhe dhunën në familje. Në çdo çështje ku përfshihet një i mitur viktimë, apo i dyshuar / akuzuar, specialistët e lartpërmendur duhet të jenë të pranishëm dhe të trajtojnë këto çështje.

13.4 Trajnimet e bëra me policinë kanë mbuluar aspektet e mëposhtme, në përputhje me Nenin 26 të KDPM-së:¹⁷⁰

1. Standartet dhe parimet që garantojnë të drejtat e të miturit;
2. parimet etike dhe detyrimet;
3. teknikat e trajnimit dhe të vlerësimit, situata të vështira, vlerësimi i riskut, referimi i çështjes dhe mbrojtja e parimit të konfidencialitetit;
4. trajnimi për teknikat e marrjes në pyetje të të miturit, psikologjia e të miturit dhe komunikimi me të miturin me gjuhë të përshtatshme; dhe
5. metodat e punës së detyrueshme për specialistët që punojnë me të mitur. .

Dhënia e Trajnimit

13.4 Autoriteti për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të personelit të Policisë së Shtetit është Akademia e Sigurisë.¹⁷¹ Programi i trajnimit bazohet mbi Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe në shkëmbimin e eksperiencës me ekspertë të huaj nga SIDA dhe UNICEF. Trajnimi zgjat 70 orë.¹⁷² Në pritje të krijimit të hapsirave miqësore për të mitur në rajonet e policisë, duhet ndryshuar qasja e Njësisë për Marrjen në Pyetje të të Miturit në mënyrën dhe teknikat e marrjes në pyetje si dhe të dokumentimit të procesit. Prandaj, Policia e Shtetit është duke përgatitur një program të titulluar “Teknikat e marrjes në pyetje nga Njësia e Marrjes në pyetje” i cili do të zbatohet nga psikologë dhe ekspertë të specializuar.

¹⁶⁸Informacion i dhënë nga Shkolla e Magjistraturës në përgjigje të kërkesës për informacion dhe nga Prokuroria e Përgjithshme në përgjigje të kërkesës për informacion nr. 443 20.5.2019.

¹⁶⁹Disa nga temat e diskutura janë: Drejtësia për të Mitur; Të mitur në kontakt me ligjin; Drejtësia Rehabilituese dhe ndërmjetësimi për të mitur; I Mituri viktimë në procedim penal; Interesi më i lartë i të miturit; Komunikimi me të mitur dhe marrja në pyetje nga gjykatës dhe prokurorë; përgatitja e akteve procedurale për drejtësinë për të mitur; Krijimi i besimit nëpërmjet gjuhës së folur, efekteve kulturore, sociale dhe ekonomike; Komunikimi, dëgjimi dhe ndjeshmëria efektive; Standartet e BE-së në lidhje me të drejtat e viktimave në procedimet penale; roli i viktimave në procedimet penale; Ri-viktimizim; mjetet për të shmangur përsëritjen e marrjes në pyetje; paragjykimet dhe ndikimi i tyre në komunikimin me viktimën dhe në cilësinë e punës së gjyqarorit / prokurorit etj; E drejta e të miturit për t'u dëgjuar; dhe zhvillimin e ndjeshmërisë emocionale ndaj të miturve

¹⁷⁰Informacion i dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në përgjigje të kërkesës për informacion nr. 4105 i datës 20.5.2019.

¹⁷¹Gjatë vitit 2019 oficerët e policisë që mbulojnë çështjet me të mitur janë trajnuar nga donator të ndryshëm. Rreth 12 oficerë policie u trajnuan në kuadër të programit Shqiptaro-Suedez për drejtësinë për të mitur (Raporti i Mbledhjes së Mekanizmave Institucionalë për Zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, 12 Nëntor 2019).

¹⁷²Informacion i siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë përmes kërkesës për informacion nr. 4105 20.5.2019.

Trajnimi i oficerëve të provës

- 13.5 Në 2019, në kuadër të programit Shqipëtar-Suedez për drejtësinë për të mitur u kryen shumë trajnime në Shërbimin e Provës. Deri tani nga ky program janë kryer 7 trajnime të ndryshme për 25 oficerë prove të angazhuar me drejtësinë për të mitur.¹⁷³

Trainimi i psikologëve

- 13.6 Në 2019, Urdhëri i Psikologut zhvilloi trajnim për psikologë në fushën e drejtësisë për të mitur, dhe çertifikoi 107 psikologë si ekspertë për vlerësimin dhe ndihmën për të miturit. Sidoqoftë, mbetet sfida për psikologët shpërndarja tek institucionet e drejtësisë (Gjykata, Prokuroria, Policia, etj) e listave të psikologëve të rinj të specializuar.
- 13.7 Përveç trajnimit të ekspertëve të sistemit të institucioneve të drejtësisë që merren me të mitur, ka pasur përpjekje të vazhdueshme për të trajnuar ekspertë të tjerë të përfshirë në proces si specialisët e mbrojtjes të të miturit, pjesë e Njësisë për Mbrojtjen e të Miturit. Deri më sot, nga organizata si UNICEF, World Vision dhe Terre des Hommes janë trajnuar rreth 160 specialistë.

14 Rekomandime

- 14.1 KDPM-ja, dhe masat praktike për zbatimin e dispozitave të saj, janë shembuj inkurajues për zbatimin e Direktivës për të Mitur. Për shembull, Kodi për të Mitur thotë se duhet të ketë alternativa ndaj heqjes së lirisë nëpërmjet një institucioni të posaçëm për rehabilitimin e të miturit duke qënë në kontakt të vazhdueshëm me anëtarët e familjes. Shumë rajone policie kanë një specialist të “njësisë së drejtësisë për të mitur” dhe mjedise të përshtatshme për marrjen në pyetje të të miturit.
- 14.2 KDPM-ja është një instrument i ri, dhe për të vlerësuar saktë efektshmërinë e tij kërkohet monitorim i mëtejshëm. Edhe pse dispozitat përpudhen madje edhe i tejkalojnë standartet

e Direktës për të mitur, eksperinca tregon se në praktike këto standarte nuk zbatohen të gjitha. .

Ndihma juridike dhe ndihmë tjetër

- 14.3 **Duhet lehtësuar qasja në ndihmë juridike falas, duke përshtatur formularët e ndihmës juridike për përdorim nga të miturit.**
- 14.4 **Duhet vendosur mekanizma të efektshëm që sigurojnë ndihmë për të miturin nga avokatë të specializuar për përfaqësimin e të miturve të dyshuar/akuzuar.**
- 14.5 **Duhet të zbatohet më me forcë e drejta për mbrojtje me avokat dhe e shoqërimit nga të rriturit përkatës.**

Marrja në pyetje e të miturit të dyshuar/akuzuar

- 14.6 **Duhet udhëzime dhe standarte më të qarta për marrjen në pyetje të të miturit në konflikt me ligjin për të kufizuar numrin e herëve që ai mund të merret në pyetje nga autoritetet**
- 14.7 **Duhet më shumë mjedise miqësore për të mitur në Rajonet e Policisë dhe vende të tjera ku merren në pyetje të miturit në konflikt me ligjin, dhe policia dhe prokuria të përdorë këto mjedise, nëse janë të disponueshme.**
- 14.8 **Marrja në pyetje e të miturit të dyshuar/akuzuar të regjistrohet me audio/ video.**
- 14.9 **Në rajonet e policisë të ketë më shumë psikologë për të ndihmuar gjatë marrjes në pyetje të të miturit dhe për t’iu përgjigjur nevojave të tij.**

¹⁷³Raportit i Mbledhjes, Mekanizmi Institucional për Zbatimin e Strategjisë për Drejtësinë për të Mitur, 12 nëntor 2019.

Vlerësimi individual dhe ekzaminimi mjekësor

- 14.10 Nuk duhet të ketë barrë financiare mbi të miturin e dyshuar/akuzuar dhe familjen e tij për kryerjen e vlerësimit individual, i cili duhet të jetë falas dhe të kryhet nga organizma publik si Shërbimi i Provës ose Njësia Bashkiake e Mbrojtjes për të Mitur.
- 14.11 Policia e Shtetit duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar praninë e doktorëve në rajonet/drejtoritë e policisë.

Heqja e lirisë

- 14.12 Duhet të merren masa më të forta dhe të efektshme për të ndaluar paraburgimin sëbashku të të miturve dhe të rriturve.
- 14.13 Duhet të krijohen institucione të posaçme për të mitur të dënuar me “kufizim lirie” sic parashikohen në Nenin 98 të KDPM-së që t’i lejojë gjykatat të përdorin këtë masë të re alternative.
- 14.14 Të rinjtë (ndërmjet 18 dhe 21 vjeç) nuk duhet të trajohen si “të rritur”, por duhet t’a kryejnë dënimin në institucione të posaçme për të mitur.

Privatësia

- 14.15 Media duhet të marrë masa vetërregulluese për të arritur objektivat e përcaktuar nga KDPM-ja për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatisë së të miturit.

Trajnimi

- 14.16 Të gjithë ekspertët e drejtësisë penale të përfshirë në procedime të drejtësisë për të mitur duhet të kenë qasje në trajnime. Trajnimi duhet të jetë me detyrim dhe buxhetimi të mos varet nga komuniteti i donatorëve.

Përfundime

Ndryshimet e viteve të fundit në ligjet Shqiptare kanë sjellë përputhjen e ligjeve të vendit me standartet minimale të BE-së përcaktuar në Direktivat e Udhërrëfyesit, dhe me disa përjashtime rregullat e procedimit penal tani duken të jenë në përputhje me ligjet e BE-së. Procesi i anëtarësimit, dhe, në veçanti Direktivat e Udhërrëfyesit, duket të kenë impakt pozitiv mbi të drejtat e mbrojtjes dhe po ndihmojnë në respektimin e standarteve ekzistuese të të drejtave të njeriut, veçanërisht ato të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut ('KEDNJ'). Reformat gjithëpërfshirëse që ndoqën ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale në 2017 kanë përmirësuar dukshëm masat mbrojtëse procedurale për të akuzuar/dyshuar në çështje penale, dhe prezantimi i Kodit për të Mitur në të njëjtin vit pati efekt të rëndësishëm për të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin.

Megjithatë, inspektimi më nga afër i ligjeve, politikave dhe praktikave në Shqipëri ngre dyshime për lehtësinë e qasjes praktike në disa nga të drejtat e Direktivave të Udhërrëfyesit. Edhe pse ligjet e vendit janë kryesisht në përputhje me dispozitat kryesore operative të Direktivave, ka pengesa të dukshme praktike dhe juridike për zbatimin e efektshëm të tyre në shumë fusha. Sfida kryesore për Shqipërinë tani është të shkojë përtej ndryshimeve në ligj dhe të transpozojë gjuhën e Direktivave, si dhe të sigurojë mbështetjen e standarteve të Direktivave të Udhërrëfyesit nga struktura më të gjëra praktike dhe juridike që lehtësojnë ushtrimin e vërtetë dhe kuptimplotë të të drejtave të personave të dyshuar/akuzuar.

Këto sfida duhen zgjidhur me metoda të ndryshme dhe nga aktorë të ndryshëm. Ato variojnë nga rishikimi i sistemit të ndihmës juridike për të lehtësuar ndjeshëm qasjen në ndihmë juridike falas dhe duke bërë ndryshime të posaçme të procedurës për dhënien e informacionit të dyshuarit, tek iniciativat më praktike, si krijimi i një skeme funksionale të avokatëve në detyrë dhe rritjen e burimeve për institucionet e

drejtësisë për të mitur. Shumë nga këto ndryshime duhet të zbatohen nga autoritetet publike dhe ligjvënës. Njësoj i rëndësishëm është roli i shoqërisë civile dhe avokatëve mbrojtës në mbikqyrjen e mënyrave si trajtohen në praktikë personat e dyshuar dhe të akuzuar. Ka rëndësi që avokatët mbrojtës të trajnohen dhe të aktivizohen për të përdorur Direktivat dhe për të kërkuar respektimin e standarteve përkatëse, ndërsa shoqëria civile të mbështetet në rolin e saj të mbikqyrësit sistematik dhe të avokatit për ndryshim

Sfidat me të cilat përballen Shqipëria nuk janë të veçanta. Fair Trials ka vënë re se shumë nga pengesat për zbatimin e efektshëm të Direktivës janë të ngjashme me ato të vendeve anëtare të BE-së, përfshirë kontrollin e paefektshëm të cilësisë së interpretimeve (përkthimeve me gojë) dhe përkthimeve (me shkrim), sisteme të papërshtatshëm për mundësimin e qasjes së shpejtë në këshillim juridik, dhe mbipërdorimi i kufizimit fizik në procedura gjyqësore. Jo të gjitha këto sfida janë zgjidhur me sukses në BE, por fakti që Shqipëria ndan shumë sfida për të drejtat e procesit të rregullt gjyqësor me Vendet Anëtare të BE-së do të thotë se ndarja e eksperiencave, dhe dialogu i vazhdueshëm ndërmjet aktivistëve nga juridiksione të ndryshme do të kishte benefite të shumta.

Duhet të theksohet se dhe pse objektivi i menjëhershëm i Qeverisë Shqiptare për transpozimin e Direktivës është avancimi i aplikimit për anëtarësim në BE, të drejtat e mbrojtjes nuk duhet të konsiderohen si ushtrim me zgjedhje (tick box) për pranimin në BE. Ndërsa Direktivat e Udhërrëfyesit ndihmojnë ndjeshëm në përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale, ato nuk janë udhëzime gjithëpërfshirëse për të drejtën për proces të rregullt. Ka sfida të shumta, si paraburgimi dhe diskriminimi racial që janë të përbashkëta për drejtësinë penale në të gjithë Europën por që nuk janë adresuar mjaftueshëm nga ligjet e BE-së. Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave themelore dhe zbatimit të ligjit nuk mund të arrihet vetëm nëpërmjet fokusit të ngushtë të Direktivave të Udhërrëfyesit— këto sfida duhen zgjidhur duke marrë masa të një spektri më të gjerë dhe me objektiva më të qarta për forcimin e të drejtave për proces të rregullt.

Fair
Trials



fairtrials.org



[@fairtrials](https://twitter.com/fairtrials)



[FairTrials](https://www.facebook.com/FairTrials)